VEHBI SKENDERI

Vjershat dhe poemat e Drinit



8SH - 1
S 66

8JH-1
566

VEHBI SKËNDERI

VJERSHAT DHE POEMAT E DRINIT

4854J
34392
BIBLIOTEKA E SHTETIT

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

I VJETËR JE TI, DRIN, AQ SA KJO BOTË...

Si një kordon i kaltër, i argjëndë
I kthjellët, i lakuar,
I gjatë pa mbarim,
Vrapon përmes Shqiprisë ti, Drin
I qeshur, i menduar
I madh... e hijerëndë.

Buron nga Mal' i Thatë,
Ku rronin gjyshrit tanë, trima, enkelejtë.
Buron nga dherat e begata të Kosovës.
Lëvizin tok me rrjedhën tënde,
Ndër ditët dhe ndër netët e kristalta,
Korijet, malet, qiejtë
Dhe kreshtat flokëthinjura të kohës.

I vjetër je ti, Drin, aq sa kjo botë...
Ç'ka thënë rrjedha jote
Dhe ç'do të thotë?

Vrapon kjo rrjedha jote, përjetësisht,
Parreshtur,

Qysh kur filloi mbi dhe e jetës ngjizje.
Gjithmonë e nxituar,
Gjithmonë sypafjetur,
Gjithmonë në marshim
E në lëvizje.

I vjetër je ti, Drin, aq sa kjo botë...
Ç'ka thënë rrjedha jote
Dhe ç'do të thotë?

PUNËTORËT

S'i kam besuar fantazmat
E shenjtorët
Me mjekrat e me vargjet e tespijeve,
Edhe kur delnin, madhërisht, prej dijeve,
Posi Hamleti Mbret, me shqyta dhe me parzma.

S'i kam besuar difat
E kuçedrat
As nuset e përjetshme shtojzavalle
Dhe kur u lmonin trimave të rënë krifat,
Dhe kur i prisnin bishës thonj e kthetra
E loznin të gëzuara nëpër valle.

Por besoj, sinqerisht, në këto hije:
Punëtorët ngjiten lart përmbi sonda,
Duke iu qepur kullave nëpër shkallë.
Dikush karrukullës [1]) me çekan i bie:
Hap saldatriçja drita mjaft të forta
E hijet e punëtorëve maten, tok, me malë.

---

1) Vegël në sondat

I vijnë malit punëtorët gjer mbi sup.
Dikush prej tyre tund çekanin prapë,
I cili ngjan sa një shtëpi
Dhe duket se diçka po shëmbet...
Kërruset mali plak e ndjen nga vetja turp.
Fshin djersët me një re. Ka vapë...

Dhe mos t'ju vijë aspak çudi:
Ky mal që s'është tundur kurrë nga rrufetë,
Nga ky çekan po trëmbet...
Dhe ka të drejtë.

SI LINDI POEZIA

Errësirë e lagët. Fryn acar i ftohtë
E zhurmëron në rrugë shiu që bije.
Tek kthehemi, një punëtor, papritur, thotë:
— Shihni, kantieri duket si anije.

Ai e shpreh këtë mendim pa bujë
E ngjan se ja përpin kjo natë e zezë.
Por ja tek hidhet Dhimua:
— Jo, jo! Kantieri gjan si port në siujdhezë.

Dhe sondat ngrenë kullat kësaj nate
E presin, qetësisht, shin' e thëllimin.
Dhe llambat shtrinë duart delikate
Si për t'u zbutur valëve zemrimin.

Por dallgët hidhen pas gabionëve,[1])
Pas rrëzave,

---

1) Arka prej teli që mbushen me gurë.

Pas pritave!...
Kantieri llamburit
E ngjan posi një port në botën pa mbarim të
ëndrrave,
Në botën pa mbarim të dritave.

Dhe teksa vërshëllen stuhia
E strukemi pas strehëve të fjetoreve,
Shikoj si lindi poezia
Në këtë natë dimri,
Mes punëtorëve.

ARMIKU

Armiku nuk del, sot, me pallë sheshit.
Është mjaft elastik e mjaft i mbledhur.
Dhe, shpesh, ai na çuçurit te veshi
Ndonjë këshillë
Apo citat të zgjedhur.

Veç rrëzave, ku mbi rrogoz, ku nën rrogoz
Ku duke ecur majë gishtave,
Thua më thua;
Ku me të qeshur, ku serioz...
Me katër rrokje derdh një lumë helm:
«Ç'më duhet mua».

Armiku nuk pushon as ditë as natë.
Të gjitha qenjet flenë:
Njerëzit, kafshët, peshqit...
Ai s'ka gjumë.
Dhe rrit, atë, ançarin degë-shpatë,
Ku gjethet shi-farmak vajisin krua,
Në rrugë, në kantier, në klub, në punë,

Që ka tri fjalë rrënjë:
«Ç'më duhet mua».

Të ngjitet pas gjithkund
Ai,
Siç ngjitet balta pas këpucëve:
Të kreh, të ngre, të miraton
Të mburr ndër sy...
E shan ndokënd, si rastësisht, me cep të buzëve;
Dhe prap të çmon guximin, aftësinë e përvojën;
Të «vlerëson»,
Nuk ke ç'i thua!
Një gjë të «vogël» vetëm do nga ti:
Të kyçësh gojën,
Me «TUTIUS»-in «ç'më duhet mua».

Dhe, pikërisht, këtë
«Ç'më duhet mua»,
E injekton, ai, tërthorazi, rrëshqitazi,
Me xheste, me vështrim, me buzëqeshje,
Me zë edhe pa zë;
Duke nxituar linkth,
Duke kaluar brinjazi,
Duke rrëshqitur barkazi,
Duke nuhatur si langua...
«Ç'më duhet mua».

Armiku kapet fort pas llafazanëve
Dembelëve dhe impotentëve,
Posi kope e ujqëve pas kërmave.

Dhe ndjen ai gëzim e lumturi
Kur shton (edhe me një) numurin e indiferentëve
N'atë regjistrin e vet të zi
Të të paqenëve;
Kur vren se në librin e të vdekurve «Ç'më duhet mua»

Edhe një i gjallë u shtua.
Kërkon t'i mbjellë ai këto pilula-fjalë
Ku mund... në politikë, në ekonomi, në kultur
Dhe rreh të ngrerë me këto tri këmbëza
Të tradhëtisë revizioniste urë...

Ndaj zjarri i baterive, shokë, le të bjerë
Mbi këto këmbëza të krimbura e të çala
Nga gjithë pikat e komandave,
Qëlloni bateri
Me zjarr të pandërprerë
Që mos të ngrihet kurrë
Kjo e turpëshme dhe e kobëshme urë.

MINATORËT

Po, minatorët — është e vërtetë —
Kullosin xhunglave të gurta.
S'flas gjë të re, kur them se e minatorit jetë
Është e ashpër
Si dhe vetë lufta.

Veç ndalni sytë te kjo pamje pakë:
Një shtresë pluhur zbardh në front si brymë;
Gërmojnë minatorët në skarpatë,
Dielli zhurit dhe erërat nuk fryjnë.

Litarët si çengel' i ndjekin prapa,
Tek varen n'atë buzë:
Çizmja qit tym. Qit shpella zjarr nga vapa.
Kur shkelin këmbët nëpër gurët shpuzë.

Djersa formon currilë laramanë
Q'u zbresin nga fytyra me përtesë.
U hahet buka, por dhe pluhur hanë...
Tek grijnë Malin e Zadejës.

Qëllojnë mitralozët matrapikë
Mbi shkëmbin që po digjet prush.
Kjo s'është këngë...
Kjo është heroikë.
Kjo pamje e zjarrtë shpirtin fllad ta mbush!

XIXËLLONJAT

Faret e kamionave bredhin nëpër kantier nga mbrëmja deri në mëngjez.

E qysh s'u lodhët fare
Kësaj nate
Dhe s'muart dot, të paktën, një sy gjumi
Aty nën strehën e ndonjë barake
Apo mbi fletëzat e rrapit buzë lumit?

Nga vini ju? Nga ç'vend e ç'mot i largët?
Më kthyet pranë sondës
Fëmijërinë
Dh'atë vërsniken «grerëz» aq të afërt,
Që zinte xixëllonja në lëndinë.

Qëndro, voglushe!
Ku nxitohesh kaqë,
Në këtë orë të vonët zallit Drinit
Me xixëllonja nëpër faqe?
Ndalohet... pa kapelë sigurimi.

Nga vini ju?
Pa shih... s'ju njoha dot, moj shoqkëza të mira.
Ju jeni rritur shumë qysh ahere.
Nuk thonë kot se koha bën çudira:
Dje xixa në një skaj
(Që s'ngrohnit askërkënd)
Pishtarë sonte ndër kantiere.

U rritët. S'jeni më aq delikate,
S'u trëmbin as burije as motorë.
M'i lani faqet me stërkala balte
Harboni nëpër shi, nëpër dëborë.

Dhe kur vështroni valët posi male,
Në ndonjë mbrëmje vjeshte me stuhi,
U lmoni me të qeshur
Perçen dallgëve,
Duke u shkelur synë plot qesëndi.

E ç'lëmë po na sillni juve, ç'lëmë,
Këtu në mes t'argjilit
Në transhe:
Në këtë natë të freskët pa hënë
Duke pudrosur ballët, shpesh, me dhe?

E ç'lëmë të begatë po na bini,
Që nuk flini,
Nga buzëmbrëmja gjer n'agimn' e ditës?
Të dashura xixëllonja,
Mirë se vini!

48545
LIBRARIA E SHTETIT
34382

MBYTJA E EGOIZMIT

Dikur, fillova në kantier punën fizike
I bindur se po bëj një vepër
Mjaft fisnike.
Kur nis më çuçurit një zë:
«Ti s'je një dosido...
Ke aftësi, ke emër
Je shoku X.
Dakord, e ndershme është puna e krahut
Porse për ndokënd,
Që s'ka merita dhe kulturë»...
E dini kush më fliste me kaq konfidencë?
Qe zgjuar tek unë
Egoja e sëmurë.

E vrejta me përbuzje dhe i fola shkurt:
— Këtu... dhe vëri pikë! —
Ajo rrëshqau si ngjalë
Dhe filloi me të butë:

«Përse ma merrni keq?
Vështromëni, me këto duar kaq delikate

E ku të mbytem,
Qysh të futem,
Në mes të baltës?
Pastaj me turne nate...
Ju lutem...
Për zotin mbrëmë gjesh u shkeva»...
I thirra prap:
— Mbaj gjuhën! —
Dhe fjalën në gurmaz ja preva.
Porse ajo e zgjati qafën vrap
Si shtergu:
— Siç duket ju më qitët, krejt, prej fillit.
Por dijeni mirë... unë»!
Dhe zu të numurojë dy-tre qind merita.
E kapa me një dorë, vrrap
Për zverku
Dhe ndërsa desh t'më gjuante me replika
E mbyta
Në transhenë plot argjil...

Por egoja vdes
E ngjallet, prap, si shtrigë:
Është me shtatë shpirtra
Dhe me shtatë krerë.
Kur fillon e zë myk, ndokush, përmbi karrikë
Mbin pemë e saj e ligë
Siç mbijnë ferrat në një tokë djerrë.

Ndaj unë dit'e natë
Shkoj në punë,

Pa e përfillur akullin, lagështirën.
E di,
Se kjo betejë është e gjatë...
Por di se njeriu rron
Edhe më shumë:
Kur vret e shkul nga zemra kalbësirën.

NATË BETONIMI

Kërcasin rrotat nëpër shina,
Sikur po shkelin xhama;
Vagonat njëshkolonë venë e vijnë
Si një karvan i vijave të para.

Na djeg gishtrinjtë hekuri i ftohtë.
Po betonimi është si një rregull
Apo si teoremë në gjeometri.
Të zbetë duken reflektorët
Si zjarret nëpër mjergull,
Si zjarret nëpër shi.

Vërtitin betonierat rreth kazanit lugët,
E cërkë e llaçit na vesit fytyrën.
Ne betonistët
Jemi si kirurgët,
Që s'mund ta lënë dot në mes detyrën.

Ja, akujt varen heje-heje
Pas strehëve dhe drrasave të vjetra.

Ne derdhim thasë çimento ndër govata
Me ngulm...
Si në një pozicion beteje.
Pa vënë re qysh na zbardhojnë mjekrat
E na rëndojnë vetullat e trasha.

Pa vënë re që buza na ka plasur
(Dy turne rresht më këmbë)
Dhe po na erren sytë për cigar.
Veç ka dhe ky mundim diçka të dashur.
Po. Ndofta pikërisht se lufta është e rëndë
E presim dhe fitoren...
Kaq me zjarr.

Po, ka edhe ky sulm diçka të bukur:
Ja, tek qëndrojmë në këtë dëborë
Të imtë dhe të thatë,
Apo tek krrusemi prej peshe,
Duke thëthirë acar e pluhur,
Ne japim, pa menduar, dhe një provë
Para gjykatëses ndërgjegje.

«Ku mbërritëm, ku? Në ç'farë thellësie»?
Për çdo minutë lajmet venë e vinë
Sikur sulmojmë drejt ndonjë lartësie...
Kërcasin rrotat përmbi shinë,
Dëbora fryn e bie.

Transheja ka uri si një ushtri e lodhur.
Stërkala llaç na varen zhele-zhele,

Nga flokët e nga rrobat.
Transheja ha, përtyp e s'ndjen të ngopur:
Mos mbeten posi tumula ndër themele
Kavernat e zgërbonjat.

Përtace janë netët në dhjetor,
Të plogëta si breshka,
Kur gdhihesh pranë oxhakut me përralla.
Nxiton kjo natë si përroi malor,
Fërkohen dritat nëpër kreshta,
Mizat e borës duken si të gjalla.
Nxitojnë si vetima rripat
E pikave të transmisionit.
Betoni rrjedh drejt plasave të nëndheshme,
Tek mund t'na futen si mafije ujrat.
Ne ngremë sonte murin e betonit
Duke menduar nipat...
Le t'na shikojnë me këtë gëzof prej pluhuri
Vitrinave kronikale të së nesërmes!

NË BREG TË DRINIT

Me orë rri shikoj në lumin Drin.
Një gjuhë të pafolur ai më flet
Në atë shtegtimn' e gjatë
Ku herë gurgullon, herë dremit, herë buçet.

Si leu ky lumë i madh,
Me këtë rrjedhë të pandalshme,
Që nuk di ku zë fill
E ku mbaron nuk di?
Diku, nën hijen e një pishe, në luadh,
Ku ruit një burim
Apo nën rrënjët e korijes me lajthi?

Nga vjen ky lumë i madh?
Nga krahëror i hekurt i shkëmbënjve,
Që duken se ndër shekuj bëjnë sogje,
Apo nga gjiu i maleve dhe gërxheve
Që zgjohen në mëngjez prej thuqurimës së thëllëzave
Dhe këngëve të zogjve?

Nga del ky lumë i madh?
Atje pas shpellave e grendave,
Ku gurgullojnë gurrat e kulluara,
E tjerrin fillin furkat e legjendave
Apo nga pyjet e korijet e harbuara?

Vështroj...
I shtangur, i hutuar nga habia
Edhe mendoj:
A s'ka të tilla rrënjë kaq të thella
Në krahëror të popullit
Partia?

Shëtit në breg të Drinit ditën, natën...
Kur shushurit pa fllad,
E zënë e tunden gjethet sikur tallen
Shëtit...në diell dhe në shi.
E vrej si rrjedh ky lumë i madh,
Mbaj vesh e s'di të shmallem
Me muzikën e tij.

Sa kroje, sa burime dhe sa përrenj,
O lumë,
Në djepin tënd të butë flenë gjumë?
A nuk ka mbledhur posi ti burime, trape
Mijra...
Nga dashuria
E njerëzve dhe maleve
Partia?

Ti nget, o Drin, si vraponjës i shpejtë.
Kreh perçen pas shkëmbënjve
E kruhesh nëpër ara.
Pastaj merr udhën drejtë, drejtë...
Zajet e përcëlluar çan përpara.

Vështroj ujrat e tua e dehem krejt
Nga kuvendim' i valëve dhe nga kthjelltësia.
A s'çan kështu, si ti, o Drin,
Përpara,
Drejt...
Partia?

FRROKU

Ne jemi ulur midis zallit shesh.
Na djegin gurëzit e nxehtë,
Ndonse bën hije mali sipër nesh
E shushurit prej flladit ndonjë fletë.

Merr fjalën, si gjithnjë, përgjegjësi i sektorit
Edhe si flet diçka, prap, tek vetvetja del:
— Në fund të fundit ç'të humbasim kohën?
Këndon mbi këtë kodër plehë
Veç një gjel! —

Lëvizin punëtorët nëpër vende me nervozitet;
Disa fillojnë e qeshin nënë buzë.
Përzjehen valët nëpër lumë
E ngjan sikur dhe Drini flet:
— Or mik, kështu si ty dikur...
Unë kam njohur shumë. —
U duken punëtorëve rëra dhe gurzit shpuzë.

Përgjegjësi vazhdon...
E flet për shumë gjëra si di veç ai.

E kërcënon ndokënd si bej...
E bën dhe ndonjë kompliment
Në adresë të ndonjë lakej...
Dhe i hakrrohet, prap, ndokujt me sy:
«Hë-hë, unë, ty»!...

Edhe si zakonisht
Bisedën përsëri e sjell,
Tek veteja e tij:
— Dijeni mirë, ju, se mbi këtë çati....
Këndon veçse një gjel! —
Dhe që t'i verë mbledhjes një kapak
Demokratik,
Si një njeri modern:
Pak liberal,
pak romantik,
Pak specifik,
Që di të shohë mirë afër edhe larg;
Drejtohet dhe në masë:
— E, shokë, kini vrejtje?
Heshtje.
Kjo do të thotë s'ka njeri ç'të flasë. —

— Jo, kam me fol, pak, unë.
— Hë, mirë, ç'vrejtje ke, ti, Frrok!
— Më ngjan se nuk e ke lexue...
— E ç'farë s'kam lexuar! — flet shefi me zor —
Më thuaj ç'farë s'kam lexuar unë... —
Dhe murmurit me vete: «Hë-hë, ç'primitiv»!
— Kontrollin Punëtor!

Përgjegjësi qesh, zgërdhihet,
Qit një hingëllimë...
Dhe diçka murmurit.
Por kur ngre sytë e sheh se kjo vërejtje shpreh
Mendimin kolektiv:
Mbaron zgërdhirja e tij në fërshëllimë.

Pastaj, me gjysmë zëri, flet, mbuluar djersë:
— Po, shoku Frrok, jap fjalën...
Do bëj kthesë. —
E ngrihet, prap, pesëdhjetvjeçari Frrok Pjetër Nika
I mbushur e leshtor,
(Në ushtri pati mësuar pakë shkrim)
Edhe i jep përgjegjsit (me tre diploma) për lexim
Librin e Kuq
«Kontrolli punëtor».

ELEGJI PËR KRYESONDISTIN

Nuk dehemi veç prej rakisë; konjakut e prej shlivës!
Nuk shkove, ti, në aksident, kot... papandehur.
U dehe, ti, siç dehen gjithë trimat
Nga vera entusiaste e ofensivës.

Të patëm parë, shpesh, shtrëngatave dhe rreshjeve
Si një vetimë n'errësirë.
Dhe aty ku tundej dheu prej ndeshjeve
Kërkoje tjetër front... më të vështirë.

Tashti qëndron, në baltë, pa lëvizur.
Një krah ke hedhur hark si pa vëmendje.
Në kanatjere gjaku t'është mpiksur;
Të shohim... e na rrjedhin lot prej dhëmbjes.

Të flasim... po ti s'mund të ngrihesh sot.
Je ndërë para nesh, këtu, në tokë
Dhe mbasi nuk mund të të vrejmë, kështu, dot
Po të mbulojmë me peliçe kokën.

Ti nuk jeton më shok!
Nuk do ta thekim, tok, më bukën në furnellë
Duke ndjerë erën e këndëshme të brumit.
Nuk do ta presim, tok, mëngjezin kur të çelë
Dhe s'do dëgjojmë këngët e valëve të lumit.

Nuk do strehohemi në shi, nën një barakë
E s'do t'i ngrohim mbi një zjarr pëllëmbët;
Nuk do ta presim, më, tufanin bashkë
Dhe nuk do rrimë, n'avari, tre ditë më këmbë.
Ti nuk do kthehesh kurrë. Është e qartë:
Ne shokët të përcollëm vetë...
Asgjë s'na le kur ike në barrelë shtrirë,
Veç disa bulza gjak aty në baltë
Dhe këto fjalë — testament:
— Do të luftoj te fronti m'i vështirë! —

Dhe i dëgjuan valët këto fjalë
Dhe ndonse s'kanë folur kurrë,
Këto tri fjalë i mësuan mirë,
T'i shpijen an e kënd, kur ndajnë oriz stërkalash
nëpër gurë:
— Do të luftoj te fronti m'i vështirë! —

Dhe i dëgjuan erërat.
Dhe ndonse erërat s'dinë asnjë gjuhë,
Këto tri fjalë i mësuan mirë,
Që t'i shpërndajnë vijave të sulmit:
— Do të luftoj te fronti m'i vështirë! —

I shkrova këto fjalë mu në gji
Ndërsa buçasin grykave përjetë.

Ti, Zef Mark Gjoka, vdiqe shumë i ri...
Kjo më takonte mua si m'i vjetër...

Por do ta ruajë Drini emrin tënd.
Paçka në i vure derës rezdën
E mbolle yje gjaku nëpër baltë.
Ti do të vish me ne kur të lartojmë Fjerzën
Dhe kur të nxjerrë në qiell furrnalta tym të kaltër.

COPA PEJZAZHESH NGA TURNET E NATËS

Sa qit prej ujit dorën prej akullit mbulohet.
UKËS-et duken si qipariz' të lartë,
Ku bie mali nënë hije, ku ndriçohet;
Ka vënë buldozeri takije të smeraldtë.

I shtrijmë pëllëmbët zjarrit, që sapo kemi ndezur:
Kuqlon ai si trëndafil në kopshtin e përthinjur
E duket, çuditrisht, i afërt e i qeshur...
Na ngroh...
E grason shkrin në mëngën e këllinjur.

Na bien cërka balte në fytyrë,
Po duart ngjeshim, prap, në baltë gjer në brryl.
Gishtrinjtë prej cingërimës janë fryrë
Shkopinjtë e akullt varen rreth si pyll.

Por ne shtrëngojmë levat e lopatat,
Si rremat lundërtarët

Në një stuhi të fortë.
Ngadalë, mu si tym, nis arratiset nata:
Fashiten yjt, fashiten, verdhen zjarret;
Mëngjezi vjen i dashur...
E i ngrohtë.

PO KTHEHESHIM NJË MËNGJEZ ME SHI NGA TURNI

Po ktheheshim një mëngjez me shi nga turni.
Na shkisnin çizmet gurëve të lagur
E na tërhiqte në fjetore gjumi
Siç na tërheq pas betonimit
Dush i vakur.

Kur ja: aty pas ledhit të vithisur
Vështrojmë, pak kuriozë, një shtëpi:
Pa tym në oxhak, pa dyer
Të braktisur...
Në prakn' e saj maçoku roje rri.

Ai lëshon të gjatën mjaullimë
Me zë të vagulluar e të çjerrë,
Ku veshët mbledh tek bubullojnë minat,
Ku vren i hakërruar buldozerë.

Kuptohet: s'mund të ndahet nga kjo strehë,
Tek mblidhesh pas oxhakut sa një gogël
Ai i gërhiste së ndjerës gjyshe në prehër...

Vajton si një bakall ai
Për lumtërinë e vogël.

Pusho, a derëzi!
Të martë lumi.
S'ka vend në këtë front
As ti
As mjaullima
Këtu do ngrihet njëzetkatsh podiumi:
Të japë koncerte kori me turbina.

GËZIMI

(Atyre që lumtërohen prej gëzimit të shokëve).

Gëzimi qesh
Posi një sofër diell në një pllajë
Një ditë të zymtë dhe të qetë.
Gëzimi të flladit
Posi fidanat në ograjë,
Kur tunden lehtë e lehtë.

Gëzimi ngroh
Si një peliçe e trashë në dhjetor
Një mbrëmje t'akullt posi qelqe;
Gëzimi vetëtin
Posi një meteor
Dhe balleve të vrëjtura të pleqve.

Gëzimi është naiv.
Si kalama llastohet,

Të flet me butësi,
Të heq me mirësi pas flokësh,
Por është e mrekullueshme kur njeriu
lumtërohet
Më shumë se në gëzimn' e tij,
Prej lumturisë dhe gëzimit të shokëve.

DEBAT NË KANTIER

Kushtuar minatorëve të tunelit të Zadejes

Kanë ardhur punëtorët llërë-përveshur,
Me rrobe pune,
Ashtu siç venë, zakonisht, në front.
Debati çelet tek një lëndinë e pjerrët dhe e zhveshur;

Ku rrjedh një trap
E verdh një shkëmb në sfond.

Nuk më kujtohet ç'pamje kish natyra,
Pat vrejtur vetullat apo buzëqeshte.
— Ka ikur shoku Telo nga detyra... —
Njerëzit vështrojnë folsin me kureshtje.

Debati nis posi një shi qershori:
Sëpari pikë-rrallë,
Pastaj rrebesh i fortë :
— Nuk është djalë i keq, por...
— Telo më ngadalë!
— Nuk i lejohet kjo një minatori... —
Dikush e vret me një shikim të ftohtë.

Dhe një me baromínë në pëqi
I thotë, qetësisht, andej nga mezi:
— Të njohësh fajin është burrëri.
Ndaj shkundu, Telo, thuaj, interesi.. —

Dhe ngrihet Telua. S'ndjehet asnjë zë.
Veç gurgullimë e trapit tek nxiton në lumë.
— Po; ika. Sepse bëra punën
Dhe s'më paguan mirë. Fundja çdo njeri.. —
— Dhe ike për këtë? —

— Ti mik bën me detyrën tregëti! —
— Pusho! Mos çuçurit si plakat buzë-strehësh. —
Kritikat çajnë qielln' si meteorë:
— Pse rreh ta lyesh fajin e ta krehësh
Posi xhambazi një gërdallë,
Që do të nxjerrë në pazar..
Thuaje copë! gabova... jemi punëtorë. —

Kurse një tjetër merr më shumë zjarr
Dhe duke kapërcyer cakn' e duhur,
Ja pret me sëpatë:
— Kjo është turp! —
Dhe shkund kjo shprehje që nga supet pluhur
Siç shkund tufani në skarpatë.

Mandej merr fjalën një zeshkan
I qetë dhe i thellë
E mat e pret... posi terziu stofën.
Mendim i tij

Ka shi, acar e diell...
Dhe si një dif, në djep, rri te kjo strofë.
— Ndaj na ka zënë qafa një gisht krypë
Duke dërsitur shkrep më shkrep
E mal më mal,
Ndaj jemi zhytur në ujë gjer në grykë
Tuneleve...
Për interesin personal!

Ju kini parë, sigurisht, një lis.
Që rritet gjer në qiell
Dhe pjell... një gogël.

U rrite, ti, o minator...
Po thuaj, pse?
Që t'i shërbesh një çështjeje të vogël
Si një i krimbur individ,
A po të ngresh Komunizmin, tok, me ne? —
. . . . . .

E kur mbaron ky gjyq i flaktë e i rreptë
Çohet më këmbë dhe ai
E hedh vështrimin rreth e qark...
Këtë vështrim fort mirë e ndjejnë
Dh'ata që ndodhen fare larg.

Dhe nis të flasë. Ç'do të thotë vallë?
— Po, shokë, kini plot të drejtë. —
Kaq flet ai...
Dhe qenë boll këto tri fjalë.
Të tjerat ua tha shokëve... me sy.

PANORAMË

Lëshojnë xhufka avujsh
Grykat, kodrat, fusha
E unë, si shtegëtar, po ngjitem të përpjetës...
Ndër mezhda e nëpër lug ka dirsur bar
E mund të gjesh dhe lule ndër gëmusha,
Megjithëse ka afruar fundi i vjeshtës.

Kamionat ecin, vazhdimisht, me ngutje
Dhe ngrenë re me tym
Në rrugët e kantiereve.
Përmbi xhade e nën xhade, një çikë më tutje:
Pirgje me gurë kthen, shpërndan e shtyn
Fshesa e rëndë e buldozerëve.

Eskavatorët shtrijnë rrotull krahët
E mbushin plot me zall
Ato të thelltat lugë.
E, për një ças, të ngjan sikur, aty nën mal,
Po del nga shpellat e harresës një dinozaur
Dhe po na pret, si pa teklif, në rrugë.

Dhe atje ku shtrihej një rrëpirë e thatë
E ngroheshin gjarprinjtë nën diellë:
Zbardhin shkëmbinjtë,
Lartohen kodra baltë
Dhe nxin si hon ai përroi i thellë,
Ku do të hidhet bazament' i digës.

Gjithkund vren qysh e shtrijnë dorën njerëzit:
Fragmente muresh, rrugësh
E kanalesh...
Dhe mbrëmjeve, mes muzgjesh
Ose në mugëtirën e mëngjezit
Përzjehen bashkë
Silueta punëtorësh, vinçash edhe malesh.

Dhe ngjan sikur i bëjnë njëri-tjetrit
Shoqëri.
Dhe ngjan sikur në këtë ansambël kaq të madh
Çdokush e ka një rol:
Dhe ajo barakë që na mbledh në shi,
Dhe ata gabionë, bregut, gardh e gardh
Dhe kullat metalike, posht'-lart, përhapur.

BISEDË ME MJESHTRIN

N. Z.

Po... Ja, këtu vështrimi ndalet.
Kolonë e lartë e tensionit
Sikur kërkon ballafaqim me malet...
Këtë, besoj, kërkoni të na thoni?

Kjo pamje s'është «Perëndim në plazh»,
As «Kuartet» borigash plot freski.
Por ka diçka të bukur ky pejzash...,
Pa ç'ka, në ka mbi të dhe pakëz egërsi.

Ka ngulur rrënjët shtylla mes shkëmbënjve,
E ngjan sikur s'përfill gëdhënjtë dhe të çarat.
Që kanë lënë shekujt rreth e qark.
Kini të drejtë, mjeshtër. Këtë mbrëmje
Ajo shikon përpara...
Shumë larg.

Kanuni para saj duket mu si një shqarth,
Që bren, si gjithë brejtësit, ndonjë drrasë.
Ajo vështron si një mendim i madh...
Që dhe me heshtjen vetë mund t'na flasë.

Qëndron ajo, shtatdrejtë piramidë,
Mbi legjendarin mal sa dheu i vjetër,
Dhe, krenarisht, i bën Evropës sfidë...
I thotë natës:
— Ndal! —
Kini të drejtë. Ajo flet shumë... mjeshtër.

MEKANIKËT

E di, se përmbi këtë poezi
Kur të shfletojnë librin, pshtetur, mureve të ndonjë ofiçine
Duart e shokëve të mij
Do të lënë njolla vaji e benzine
Dhe do t'i shkelin mekanikët, ndokujt, synë:
— Këtë e shkroi për ne...
Një shoku ynë. —

Më njohin mirë mekanikët:
Selua, Marku, Leka, Petri,
Sa herë kemi pshtetur kokën në dremitje
Ne, supeve të njerit tjetrit
Dhe jemi ngrohur, tok, pas rezistencës.
Sa herë i kam çuar nga krevati
Mekanikët,
Mjekët e urgjencës.

Dhe kur janë tulatur sondat në qetësi
Edhe ka shtrirë heshtja an e kënd qerpikët;
Mbi këtë heshtje agoni

Janë vërsulur mjekët e urgjencës
Mekanikët!

Edhe nuk dinë ata ankime, skerca, teka
Se m'u prish sonte rregulli e qetësia
Dhe s'dinë ata t'i tjerrin fjalët si tërkuzët.
Në do të dish se ç'është avaria
E ç'është në sektorin tonë heshtja:

Vështro se si e thith cigaren Leka
Pa ndjerë aspak qysh po i digjen buzët.
Gdhihen e ngrysen pranë punës përsëri
(Nuk ke ç'i thua, avari!)
E s'pyesin ata sa kohë shkoi...
Unë kam parë Petrin
Shtrirë nën shasi,
Në tokën e notisur e të zezë,
Me shpatulla përdhe
Dhe mjekrën e pudrosur ndryshk në ngjyrë-bezhë:
Duke kërkuar një difekt... dhjetë orë pa lëvizur
Pështetur kokën sipër heshtjes
Mbi një jastëk vare.

E s'pyesin mekanikët borë e furtunë,
Kur ndodhin avaritë
E bije heshtja, pa pritur, në punë.

E dimrave
Kur mbijnë brirë gurëve nga ngrica
Pa zënë e duken posi copa akujsh dadot, fllanxhat:

E s'pipëtijnë rrugët si të vdekura:
Kërkojnë mekanikët heshtjen
Nëpër hekura,
Me duart plot gëdhënj porsi ganxha,

I njoh mjaft mirë mekanikët.
Punojnë midis hekurave të shurdhët e të ftohtë
Qëllojnë me çekan në buldozer zinxhirat...
Dhe janë aq delikatë. Kanë shumë botë.
Bëjnë debat plot me zjarr për politikë;
Merren me shkencë, letërsi, muzikë...
Dhe mund të shoqërojnë me spinotë gjithë melodirat,
Që hap Radio-Tirana nëpër tokë.

I kam shokë të vjetër mekanikët.
Qëllojnë me çekan;
Lëvizin pesha
Dhe Kopernikun e smontojnë me çelsa,
Veshur me ato kominoshe gjithë graso ngarkuar.
Veç kur shëtitin djemtë bulevardeve
S'i shquan; kursesi, mes elegantëve...
Por unë, prap, i njoh ata...
Nga duart.

KULLA NË FUND TË LIQENIT

Shtëpi e gurtë rrëzë kodre,
E shkove ti tulatur jetën.
Të vareshin kulmeve llatka bloze
E qysh s'u lodhe shekuj... vetëm?

Shqetsoheshe dhe në qetësi
Shtëpi e gurtë plot frëngji.

Qëndrove ti si karakoll,
Duke përcjellë kushdi sa breza.
E verdhacuku shenjt' Shënkoll
Bekonte pushkët ugurzeza.

Dhe dridheshe nga gjëma ti,
Moj kullë e gurtë plot frëngji.

S't'u shemb ky ball' i ngushtë, i lartër.
Kur plumbat grryen gdhënj'e rrudhë
Po të mbulojmë te ky varr i kaltër
Mu si detarin, që vdes mb'udhë.

Në fund të gjolit do flesh ti,
Moj kullë e gurtë plot frëngji.

Hutat do t'i mbulojë ndryshku
Tek dergjen hatujve të shkretë;
Frëngjitë do t'i zërë myshku
Me ata fij' mëndafsh të blertë.

Mbaroi dhe jotja pleqëri,
Moj kullë e gurtë plot frëngji.

E përmbi varrin tënd të thellë
S'do mbinë hardhi as driz'as bar;
Miliona xixëllonja-zjarr
Do lejnë nga ai sy i kthjellët

E do të derdhen mbi malsi
Si një mëngjez i kuq... i ri.

I SHKRETI... PSALLT

«— Parajsë e humbur s'kthehet kurrë.
— Për ç'parajsë e kini fjalën, or mik?»

Nga një dialog

Më qenke qepur, prap, me gur në trajsë.
Ç'borgjez a ç'prift ta dha sot këtë gur,
T'më gjuajsh mua?
Ti ulërin: «S'vjen më ajo parajsë»!
E për ç'parajsë, or mik, na thua?
Ajo që humbi prifti yt dikur?...

Me kë e ke? Me mua? Shqetësohesh përsëri,
Sepse kam humbur unë një karrige,
Të cilën ti e quan lumtëri?
Ore qyqar,
I thuaj atij priftit tënd të zi,
Mos shesë të tillë çorbë «filantropike»,
Duke të qitur ty, tellall, nëpër pazar.

Me kë e ke?...
I thuaj atij priftit tënd të majmë,
Që gdhin, i mjeri, kushedi sa net,

T'na pregatitë ndonjë turtë,
«T'ëmbël e të «sfungjertë»,
Se di që të luftoj me pendë dhe me kazmë...
Parajsën unë e gjej në luftë.
Me kë e ke?...

Jam zhytur gjer në brez në argjil dhe në baltë.
Jam bërë, shpesh, i tëri graso, pis,
Kam ngulur shtylla poshtë e lartë,
Kam mbajtur dhe çimento në kurriz,

Duke pështyrë mbi lmoshën preferencë,
Por qasmu pak, këtu, i «ndershmi» mik!
Të lutem nuk më thua:
Mos të kam thënë ndonjë ditë
T'më sigurojë yt zot ndonjë indulgjencë
Edhe t'i lutet zotit Krisht për mua?

Me kë e ke? Me mua përsëri?!
Ti më llois kush je edhe kush jam...
Se jeta qenka «fort e rëndë» e s'qenka fushë.
Dëgjo! I thuaj atij priftit tënd të zi,
Që fshihet si nepërkë s'di në ç'guvë:
Unë jam komunist.
Dhe komunisti nga çdo istikam
Me plumba priftit barkun mund t'ja mbushë!

Me kë e ke? Hë-hë!
Të dogji «terapia» me kobalt.
Pse mblidhesh si iriq dhe nuk nxjerr zë?
S'ka më për ty parajsë...
I varfri psallt!

TRANSPORTIMI I SHOFERIT TË PLAGOSUR

Ti u plagose rëndë në kantier,
Kur po buçiste kori i motorëve dhe borive.
Ti ishe dyzet vjet shofer...
Përmbi timon thuajse ishe plakur.
E ç'deshe që t'u thoshje më të rinjve
Me heshtjen... dhe këmishën e përgjakur?

Të hipën, shpejt, në një karroceri të hekurt.
Këtë, ti, shokëve besoj ua fal.
A po jo? S'u ndodh, përdreq, ndonjë veturë.
Kamioni mori vrapin si i çmendur,
Duke kërcyer nëpër gropa e gurë,
Të arrinte sa më parë në spital.

Kamoni merrte si vetima kthesat
Dhe, çuditrisht, s'po i qortoje shokët ti:
— Hej, djem, mos shkelni rregullin! —
Ti heshtje...
Nga peshë e dhëmbjes dridheshin balestrat.
Kamioni çante rrugët me furi
Dhe linte pas një bisht të verdhë mjergulle.

Të mbanin tre shoferë
Në pëqi.
Të mbanin plot kujdes,
Që të mos të të lëndonin.
Kamioni shkiste në xhade si erë!
Dhe, në këtë udhëtim,
Që u shtinte kalimtarëve tmerrë:
Shqetësoheshin ata, çdo çast, për ty... mos të lëndonin.

PËRPLASEN ANTITEZAT

Takohen rrjedhës së Drinit gjeth' i ahut
Me fletëzën e fikut,
Edhe bariu që ndjell këtej kopenë
Këndon për Basho Mujon e për heronjt' e Vigut.

Ka zbritur një malsor nga fshat' i vjetër
Me kryqn' e kumbonares të rrënuar
Q'e mban, ilegalisht, në një furrik të zemrës.
Por vrejeni petritin mes petritave.
Nuk duket tjetër?
Si trim ai punon për të ndërtuar
Kolosin shqipëtar të dritave.

Ka zbritur një malsor këtu në Vah,
Ashtu siç vjen përroi pas shirave
Plot vrull e hove brënda.
I sillen mëntë rreth si kuajve në vrah...
Përballë mundësive dhe dëshirave,
Kur ndodhet mes maqinave të rënda.

Takohen te ky lumë gurëzit e dherat,
Që bartin ujrat prej maleve, brigjeve e kodrave.
Takojnë njëra-tjetrën dhe përlpasen erërat,
Tek ngasin grykave
Nga largësitë e kohrave.

E zënë fill, këtej, mitet e gojëdhënat.
E mpleksin fijet
Këngët, fiset, brezat...
(Dhe ndërsa ndjehen, së largti, klithmat e të shtënat
Si akujt n'oqean
Përplasen antitezat.

Dhe nga kjo ndeshje kaq madhështore
Lind diga,
Që si mal... mes malesh pështetet.
E gjaku i mpiksur nxehet e lëvrin.
Kaliten detashmentet punëtore...
Oriz' e lumturisë mbjell korrieri Drin
Në fshatrat e qytetet e së nesërmes.

NË DHOMËN E DEZHURNIT

Përjashta rrjedhin retë si me gjyma,
I ka mbuluar rrugët inondata.
Rrëketë e turbullta në barakë hyjnë
Shkëlqejnë xham nga llamba.

Por nuk i ngjall kurrkujt kjo pamje tmerr
As nuk krijon habi:
Në zyrën e dezhurnit, në kantier.
Vërshojnë dhe rrëke...
Kur bie shi.

Një pshtetet në krevat, mbi batanije;
Një mbi tryezë ja ka shtruar shesh.
Kurse i treti mbathur shik...me çizme
Në ujë gjer në gju, pas telefonit, qesh.

Dhe, vetvetiu, pa plan, pa skedë,
Si një burim që rrjedh, ashtu, natyrshëm
Fillojmë që të katër një bisedë
Rreth filmave të ndryshëm,

E futen, një nga një, në dhomën tonë,
Pa reverança e pa bujë,
Çaplini, Zhan Gabeni, Mihail Romi!
Brixhida zbathur zhytet nëpër ujë.

Pastaj si intermexo
Një kuplet i Raxhit,
Si për freski mbas mbaresës tragjike
Të Merilin Monrosë.
Një mi,
Me siguri «Miu budalla» i Xhaxhit[1]),
Ka hipur mbi këpucën,
Që lundron si kaike.

Mandej vazhdon biseda më me zjarr:
(Jo për Lorenc Oliverin e për Ledin)
Për Ndrekën, Loron tonë dhe për Edin.
Për filmin shqipëtar.

Kështu dhomë e dezhurnit gjallërohet:
Ne ndjejmë nëpër deje krenarinë,
Si një gëzim pas sulmit,
Pa vënë re se uji që po shtohet
Mbulon përgjysmë komodinën.

1) personazh i poemës për fëmijë të shkrimtarit Z. Sako.

PRITJE

Nuk presim, pranë radios, transmetimin
E ndeshjes së skuadrës tonë
Diku në vend të largët.
Nuk presim as fillimin as mbarimin
Në ndonjë Maratonë,
Ndërsa na lag një shi i dendur e i vakët.

Nuk presim dy dekada pas martese
Fëmijën e parë
Tek një sallë lindjeje,
Si një behar të vogël në një stinë vjeshte.

Nuk presim tek një shteg, pranë një parku,
Teksa ja shquajmë zemrës çdo trokitje.
Një siluetë që lëviz së largu...
Kjo është tjetër mall e tjetër pritje:

E shkuam sonte natën mes thëllimit
Nën këtë qiell të kthjellët si përrallë.
Në punë ikën, shpejt dhe natë e dimrit.
Porse kjo natë eci, mjaft, ngadalë.

Acari fryn si fishkëllim i mprehtë.
Përplasim këmbët nëpër akull
(Kemi punuar turni i tretë)
Në majat e gishtrinjve ndjejmë dhëmbje
Dhe presim...

E sytë hedhim, shpesh, drejt grykave përpjetë
Me një gëzim të çiltër.
Po. Presim Diellin!
Shih! Tek po qesh kopili mes shkëmbenjve
Si ndonjë çunak i gëzuar
Që mban gështenja avulloshka në kanistër
Mbi krye
Dhe buzëgas «Mirëmëngjes»! — na thotë.

Dhe ndonse dimë mirë q'ai s'do na ngrohë,
Në këtë mot të ftohtë,
Ndjejmë kënaqësi, gëzim, zbavitje...
I shkrova këto strofa, që çdokush të njohë
Mes qindra pritjeve:
Këtë të thjeshtë dhe të këndshme pritje.

POEZIA IME MË E BUKUR

«Shkëmb më shkëmb, o burra, ç'po gjëmon marteli,
Ky tunel që çelim është minierë dielli».

Nga një pllakat në tunel

Hej, njihuni me poezinë time më të fortë.
Hej, njihuni me këngën time më të bukur!
Ajo nëpër çdo provë
Në post qëndroi pa u tundur.

E shkovra një mëngjez për një pankartë,
Ca minatorë e ngjitën tek tuneli;
Shkëlqenin vargjet në një sfond të zjarrtë
Me shkronja ngjyrë dielli.

Shpërthenin minat, rrotull, pa ndërprerë
Dhe re me tym shpërndante dinamiti;
S'u krrus ajo nga frika asnjëherë,
Prej tymit të betejave s'iu zu shpirti.

Gjëmonin minat si batare lufte
Dhe xhamet e dritareve kërcisnin.
Ajo nga pozicioni, prapë, s'tundej
Orteqet e shkëmbënjve nuk e vrisnin.

E kur kalonin pranë minatorët
Me një martel mbi sup, përthinjur pluhur flokët
U rrokte ajo me tërë forcën dorën
Siç ngjatjetohen në istikame shokët.

PËRCJELLJA

Nënës

Janë rrëzuar retë mbi çati
Mu si shamia jote përmbi ballë.
Po më përcjell ti, nënë, përsëri...
Pa folur asnjë fjalë.

Kalojmë pa vëmendje nëpër pellgje;
Po më përcjell, sot, nëna prapë larg...
Si shpellë më rëndoka në ndërgjegje
Kjo kokë e saj e thinjur
E krrusur pak.

E ç'po mendon, më thuaj, plakë e urtë?
Mos të kujtohet ai dimr' i largët,
Kur më dërgoje përsëri në luftë,
Pa m'u shëruar mirë plagët?

Vërshojnë ujrat. S'ke nga të kalosh.
Mezi çapitesh ti, e dhimsur plakë,

Sikur po mban mbi supe si dikur
Thesin e misrit bosh...
Dhe s'ke mjellë t'na gatuash darkë.

Po, u rrëzova. Veç jo si aherë
Kur hidhesha nëpër kashtë me vërsnikë...
Ka shkallë, hon' e lartësi
E dallgëzuara dialektikë.
Po komunisti me njëqind plagë të bjerë.
Ka forcë që të ngrihet përsëri!

«Pse ngjau kjo? Si? E qysh? Mos qe e thënë»?
Ke net që ti vë për nënëkrye
Këtë jastëk të gurtë plot pikëpyetje..
Oh, këto pyetje natën sa të lodhën!
Kur këputesh, sado pak, nga toka dhe nga rrënjët
Të gjithëve, nën' e dashur, mund t'na ndodhë....

Harrova qysh ngjyenim mes shëllirës
Bukën
Dhe testamentin e shkruar nga shata,
Ndër ato duar të plasura dhe të ashpra,
Që kurrë të ashpra nuk m'u dukën.
Harrova... ç'duhesh më tepër
Se të harrohesh ky testament i shenjtë?..
. . . . . .
Kalojmë pa vëmendje nëpër pellgje,
Po më përcjell, sot, nëna prapë larg...
Kur ja ndalon:
Më ngjan se u jep përgjegje
Pikëpyetjeve q'i vërtiten rreth e qark.

Dhe, çuditrisht, pa e përfillur moshën,
Ajo ngre kryet si dikur... përpjetë.
Nga qiell' i vrënjtur bie shi e llohë
Përmbi çati fërkojnë faqet retë.

Por le të bjerë e le të fryjë stuhia,
S'njeh zemr' e nënës, jo, mot të vështirë:
— Shko, bir, atje,
Ku të dërgon Partia.
Të kazmës jemi ne...
Shko, bir. T'më bëhesh komunist më i mirë. —

Kalojmë pa vëmendje nëpër pellgje,
Po më përcjell, sot, nëna prapë larg...
Një rreze ma ndriçon e ngroh ndërgjegjen:
Po më përcjell prap nëna
Kokë lartë.

NE JEMI ALPINISTË

Mësuesit Ismet Sali Bruçaj.

Ne jemi udhëtarët e rrugëve të largëta,
Që s'ngelemi mes lerave prej lodhjes,
Si ndonjë kalë i plakur e i ngordhët.

Ne jemi alpinistët e pikave më të larta
Në majat e pashkelura të kohës.

Kemi pushtuar shumë lartësi,
Në kontinentet e ndërgjegjes të njerzimit,
Të tjera lartësi na presin.

Ne ngjitemi e ngjitemi
Përsëri,
Duke e lënë poshtë si një kodrinë të ulët...
Everestin.

VËSHTROJ TË BUKURËN...

Përpara meje ngrihet shkëmb' i egër
Si një bajloz i kohrave të shkuara;
Ca tumba drizash i varen si mjekër
M'i ndrijnë vesërat ballëve të rrudhura.

Blerojnë fije bari mes të çarave,
Verdhojnë si medalionë ata gjëmbush' t e njomë,
Kaltrojnë disa lule pranë zgavrrave...
Po, si ashik, thinjoshi hap aromë.

Qëndron ai mes shiut e mes dëborës
I rreptë e hijerëndë mu si mburojë epike.
Ç'm'i rri mbi krye bij' e Pitagorës
Shtatdrejta pikë trigonometrike.

Dhe shumë erë turneve të tretë,
Kur dël ky shkëmb prej muzgut të mëngjezit
Vështroj pa u nginjur... të bukurën shtatdrejtë,
Në një kuvend pa fund me kohrat dhe me njerëzit.

LINJAT ELEKTRIKE

Zgjatohi mbi kodrina, gërxhe e brigje,
Duke vërshllyer mbrëmjeve në shi
E duke mbartur supeve lakuriqe
Miliona kilovatë energji.

Nxitoni nëpër fshatra e qytete,
Hamej të mrekullueshëm fantastikë,
Pa çka dhe po të krruseni prej peshe
Tek ngjiteni brinjave ngarkuar me dritë.

Shoqroni pa përtuar përmes shinave
Trenat e kuq ngarkuar udhëtarë;
Duke u rënë sirenave luginave
Dhe duke ndjellë Komunizmin pranë.

Dhe u shpini juve tokave të plakura,
Të përcëlluara prej vapës e prej brymave.
Shëndetin e mëngjezeve të përflakura
Hovet e rebeluara të rrymave.

Dhe përmes levave prej kobalti të stacioneve
Futni nën një komandë të plotpushtetshme
Lumenjtë që si dhi kërcejnë honeve,
Lumenjtë e gjithë gurrat e pashtershme.

PO ZBRET KJO MUGËTIRA LARAMANE

Po zbret kjo mugëtira laramane:
Ku ndrijnë yjtë,
Ku davariten retë.
Dhe shkëmbi q'e shikoj në siluetë
I shëmbëllen një kaske
Stërvigane.

Pastaj, në çast, në sfondin bardhë e zi
Del hëna majë kaskës...
Si një bri.

DHE SHTRIJMË DEGËT SHEKUJVE QË VIJNË

Punojmë, pa pushim, këtu në zall
Dhe puna nuk ndalon as ndër të diela.
Qëllon kjo daltë e rëndë posi mal
Gjithnjë më poshtë...
Në shtresat më të thella.

E ç'do të mbjellim ne te kjo ranishte,
Që dimrit ngrin kallkan e verës digjet zjarr
Dhe s'mund të rritë dot (e varfra) një misrishte...
Veç ndonjë gjëmb jetim
E ndonjë trumbë bar?

E ç'do të mbjellim ne në këtë tokë strallë
Që të kujton ujemin në mulli.
Nga ç'brinja dhe nga ç'lugj' e kanë sjellë vallë,
Shirat që grryejnë truallin si ngjerdhi?

Gërmoj me daltë thellësive prapë
E, dalngadalë, shkon mesnata vonë.
E ku rrëmihin sot? Ç'epoke i përket kjo baltë?
Mos vitit dyzet mijë përpara erës sonë?

Sa shtresa dheu e breza u mbuluan
Ndër këto gryka t'egra, ku erërat oshëtijnë!
Lëshojmë rrënjë shekujve që shkuan
Dhe shtrijmë degët...
Shekujve që vijnë.

PIKTORES

Ti po qëndron në këtë buzë lumi
E vetme, fill
Tashti në mbrëmje.
E qysh s'të trëmb ky mal,
Që të vështron me një farë zemërimi,
Kur duart ti po zgjat mbi atë trëndafil,
Që la mbi të, kalimthi, perëndimi!

Ti hedh, nxitimthi, në pëlhurë penelata
Me ngjyra dhe me drita diçka për botën thua;
Pa vënë re qysh të tërheq pas flokëve të gjata
Ky Drini, miku im, që duket sa të pa...
U dashurua.

PO TË MOS MBAHEJ NDEZUR KJO BETEJË...

Kushtuar shokëve të organizatës-bazë të kantierit Digë-Tunel.

I shkojnë djersët, minatorit, valë-valë
Sikur ka pirë një zamzan me verë.
Me zor si me proteza e nxjerr fjalën...
Hutohet,
Ngatërrohet

E nganjëherë
Verdhet skuqet flakë
Si nxënës i rrëzuar në provim.
Pa nis e kruan ballin me shuplakë
Duke lëruar baltën me gishtrinj.

E vrejmë me kujdes. Prap është yni...
Duket ai posi një shkëmb i shkrehur,
Që nxjerr pas minave fjolla tymi.
— Po, shokë — thotë, — shpesh jam dehur...

— Edhe ke lënë kalamajt pa bukë! —
— Edhe ke shtrirë dorën si lypcar!
— Edhe i thua vetes komunist!..
— Edhe je shkrryer nëpër rrugë! —
Ushtojnë fjalët thellë posi pushkë,

E derdhin fjalët plumb e qitin fjalët zjarr.

Dhe qiellin e barakës flakë e ndezin.
Po ja tek ngrihet, tej, një «shtuf» i butë:
— Avashni or të uruar. Shihni... po e vdesim!
— Ti shok mos u vajis. Këtu i thonë luftë.
— Si, si?! E kë luftojmë vallë?!!

— Vesin! —
Këtë replikë të idhët me një fjalë
E hedh një zjarrmëtar sy-xixë; pak nevrik.
Zotron, një çast, në organizatë heshtja.
Dhe ai, sërish, me shprehje mjaft të thjeshta
Bën këtë konkluzion të madh... filozofik:

— Po mos të mbahej ndezur kjo betejë
Po mos të shkundej, pa pushim, ky byk
Do të na ngrinte gjaku nëpër deje
Dhe do të zinim, si kënetat, myk.

Dhe aq sa kà gjarprinj, mushkonja, karkalecë,
Nëpër bataqe, grenda e nëpër gurë,
Do kishim vrasës, vjedhës, pijanecë...
Dhe plagët e Atdheut nuk do shëroheshin kurrë. —

Dhe ndërsa klithin (si për të përshëndetur)
matrapikët,
Që nga skarpata,
Mbaron pretenca kundër vesit si i «rrezikshëm»
E i «pandreqshëm».
E minatori del, shih, nga organizata:
I lehtësuar, i vendosur...
I shëndetshëm.

GRIMCË E RËRËS MUND TË JETË BOTË...

Ku dihet? Grimcë e rërës mund të jetë botë,
Me një sistem të gjerë.
Atëhere, për këtë njeriu ç'të thotë?
Përtyp në ditë mijra ton rërë
Dhe në tre muaj
Ha një mal të tërë.

Ngul dhëmbët metalikë ashtu si pa teklif
Përmbi ranishten,
Që ku di ç'dreq epoke i takon.
E tek e vren të shëmbëllen me babagjyshin dif.
Shih! Lumverdhat si ferishte
I përkëdhel, i shan... dhe i mëkon.

Eskavatori!
Ç'hyn këtu përralla
Me babagjyshin, dif, mjekrosh,
Që mund të shembë me një shqelm një faqe mali?

Këtë përbindsh, gjigant apo... kolos
E heq, mu si deve, për kapistalli.
Ja, shihni, ky djalosh.

MESNATË

Ja, drita ngjyrë-vjollcë e saldatriçes
Si shpend prrallor tund krahët mbi shkëmbinj.
Po bie shi.
Mbi mëngët e peliçes
Një grusht margaritarësh farfurin.

E dashur, prap, me ty dhe kësaj nate jam.
Ndërsa po fryn veriu si në dhjetor
Unë mbledh pikat perla...
Thur për ty gjerdhan,

T'u mburresh shoqeve ndër të diela:
— Shih, ç'më ka sjell' ai
Im shoq punëtor!

MË DUHET NJË MENDIM I MADH... I HIJSHËM...

Në malin lakuriq vështroj, shpesh, bar të gjelbër.
Ai bleron diku nëpër tarraca,
Diku në monopate;
Kurse përmbi një gur, në një të çarë
Një lule paska çelur petale delikate...

Nuk është majë e Danjës kaq e egër
Sa duket në shikimn' e parë.

Kaloj rrëzës së malit, nëpër rërë,
E dallgën po ndjek pas tek gurgullon zgllominave.
Më duhet një mendim i thellë dhe i gjerë
Të flasë për muzikën e turbinave.

Kaloj në breg të lumit mbi haliçë
E ballin po freskoj me gurrat e sa maleve.
Më duhet një mendim i madh
I hijshëm
Të mbajë mbi supe energjinë e dritën
E gjithë hidrocentraleve. —

Ne ngremë diga, sot, këtu në Drin
E qullemi
Dhe kripemi prej djersëve:
T'u falim gjak të ri,
Qyteteve të rinj...
T'u bëjmë shoqëri dhe pas tre shekujsh
Njerëzve.

NATË DIMRI, RRUGËVE TË KANTIERIT

Çapitemi me zor mes erërave që fryjnë
Sikur kalojmë pas shirave ndonjë lumë.
Stuhia na vërvit zhavor e brymë;
Pushtojmë me mundim çdo pash rrugë.

E dukemi si lundrat në shtërgatë.
Veç prap vazhdojmë kursim plot vëmendje...
Dhe, si pushojmë pak përfund skarpatës
Tek ai «gji» i qetë rrëzë shkëmbenjve,

Përplasemi sërish me gjithë korrentet,
Që zbresin sonte maleve si të marra!
Kërcasin shtyllat e tensionit.
Ndonjë shembet.
Rrëzohemi dhe ne ndokund...
Por çajmë, prap, përpara.

TY, NDOFTA, DO TË TË DUKET...

Lidkës

Ty, ndofta, do të të duket sonte n'ëndërr
Sikur cicrojnë zoqtë nëpër pemë.
Jo. Gushëkuqët si dhe ti... po flenë.

Po cicëron mes telave veç morsi;
Nxiton që të sjellë urimn' e babit
Prej mureve të digës:
Gëzuar Një qershori!

Në pafsh, varur pas murit, në mëngjez, kordele
Mos pyet me çudi se kush ta solli.
Ka bredhur babi kushedi sa male

(E priti babi zgjuar, në turn, sot mëngjezin)
Kordelen më të bukur të agimit zgjodhi
E ja... ta solli ty
Për Një qershorin.

JA MBUSHËM MALIT PLOT TROTIL KRAHRORË

Ja mbushëm malit plot trotil krahrorë
E ç'do t'na lindë, vallë, shkëmbi?
Minj, nepërka, bisha?
Lëkunden mijra ton masiv shkëmborë
Sa dridhet gjithë vëndi.
Ç'po shëmben, përsëri, me rrapullimë kishat!

Ja mbushëm me trotil krahrorin malit,
Po vallë ç'do t'na lindë?
Murrana, kryqe, shkrepa?
Me mijra ton shkëmbinj nga hijet dalin:
Zhvendosen malet dhe kohrat nëpër Drin.
Mbaron mesjeta!

Ja mbushëm plot trotil, prap, barkun shkëmbit
E ç'do t'na lindin, vallë, gërxhet?
Xhindë, djaj, despotë?
Lëvizin mijra tonë gur nga vëndi,
E ngjan sikur dhe mali vetë shëmbet...
Këtu nuk shëmben malet, por një botë.

Ja mbushëm barkun tokës plot trotil.
E ç'do t'na lindë prej saj?
Tërfili, drita, misri?
Po shtrohen gërxhet, malet, rrymat
Vaj!
Po lind mbi Drin' e shpejtë
Komunizmi.

NJË PEJZAZHISTI...

Më fal. E ç'po qëndis, kështu, prap me penel?
Një gur, një copë kaltërsi
Pak qiell,
Retë
Dhe sondat përmbi lumë.
Nuk e ke keq...
Veç do t'qe dhe më bukur
Sikur t'na thoshje qysh gdhiu turn' i tretë
Një natë dimri me furtunë.

E duam lindjen e perëndimin
Dhe bagazhin,
Që mbjellin ata aq bujarisht mbi këta vënde.
Por të them sinqerisht
Pejzazhi
Sot ka diçka të re ndër këto gërxhe.

Pa çka,
Në qoftë se nuk ndjehet hiç mes kësaj teme
Shushurim' e barit dhe e fletëve.
Por mund t'na i japësh që tashti
Ngjyrat e tingujt e asaj poeme,
Që do të lindë nga ky pejzazh...
Pas dhjetë vjetëve?

ELEGJI PËR SHOFERIN

M. D.

Kurrkush si ti s'e njohu varfërinë.
Ajo të tundi s'di sa herë rrugëve
Dorën e pocaqisur e të verdhë.
Ti pate pasagjere urinë,
Ti pate pasagjerë, shpesh, të mjerët.

Kaloje fushave të sëmura moçalishte,
Kaloje tokave të thata tërë plasa.
Ti e pe Thumanën e Tërbufin çishin
E qysh u tund ky vënd kur shembëm klasat.

Ti udhëtove...
Gjysmë shekull jetë.
E pe atdhenë, rrugëve, siç qe...
Pe qysh u ngrit me sulm Shqipria e Re...
Dhe pe te Vau i Dejës Atdhenë që do jetë.

Ti u plagose një mëngjez
Të vonët.

Të ngelën një shuk pece nëpër duar
Edhe një çels englez;
Ndërsa nxitonin në kantier kamionët
Me gurë, baltë dhe zhavor
Ngarkuar.

Ti po lëviz. Ti do të ngrihesh lart!
E ç'po kërkon me ngulm, ashtu, në botë
Me atë çels englez në duar?
Diçka të ngeli pa mbaruar...
Diçka mbaroi... nën atë rrotë.

Të dhimbte fort prej plagve gjoksi, mezi...
E kur ja dhanë shokët gjëmës,
Ti nuk e ndjeve zhurmën.
Veçse mes mjergullës së dhëmbjes
T'u duk se mbi Cukal po shkrepte, prap, mëngjezi;
Sikur u ngrite, vrap... fillove punën.

E mbete ti, kështu, gjithmonë në timon...
Shoferi i kantiereve përjetë.
Nga xhamet e pluhrosura, prap, vëlla, shikon:
Punëtorë, pirgje gurësh e beton
Shikon...
Shqiprinë si do të jetë.

NDËRRIM TURNESH

Po marrim ca thëriza akulli në çizme,
Acarin që na than fytyrën,
Një si puhi të bardhë mbi peliçe
Dhe po u lëmë si këmbim:
Detyrën...
Plloshadkën me dëborë e natën me thëllim.

E çfarë u lëmë, vallë, tjetër?
Ndalni pakë:
Një turrë prush
E dru, ç'na kishin mbetur.

Dhe muarëm prej jush
Të drejtën që të hamë darkë;
Të drejtën... për të fjetur.

Përtace janë netët dimrave të ftohta.
Të ngjan se dhe sekondat
Çapiten mengadalë.
Punojnë, ritmikisht, gjithë natën sondat
Dhe na e shkundin gjumin nga qepallat.

Rëndohen degët e borigave nën borë
E ndodh që thyhen nga kjo peshë.
Rëndohen dhe supet tona, shokë punëtorë.
Po s'thyhet punëtori edhe sikur të vdesë.

...Fillon e zbret mëngjezi përsëri
Gazmor, i papërtuar gjithë jetën.
Nxiton
Në rrugët e kantierit turn' i ri
Dhe merr prej shokëve stafetën.

DITË VJESHTE

Verdhon ky bar' i thatë nëpër mezhdat,
Që kanë lindur grendave, s'di në ç'kohë.
Në digë sondat, sot, mezi frenojnë levat;
Në zall po bie shi,
Në mal po bie llohë.

Por shpejt fillojnë e davariten retë,
Ca trumba rrezesh ndrijnë;
Te majë e Danjës gurët farfurijnë:
Sikur s'ra shi po copra yjsh nga qjejtë.

Dhe, ja sërishmi, vjeshtës sonë larushe,
Që veshjen ndrron sa herë mëngjez e mbrëmje,
Po qesh aq ëmbëlsisht... përmes shkëmbënjve
Si lot gëzimi rrudhave të gjyshit
Ajo:
Jetëshkurtëra rrëkele gjarpërushe.

VREJ NGA DRITARJA...

Vrej nga dritarja këtë shkëmb gërdallë,
Q'e ka rrëmihur era, shiu dhe ndryshku.
Nuk sheh mbi të një vragë apo një shkallë
Veç pak bërçlem e ca vurrata mŷshku.

I varen disa xhunga mu si torba,
Si plagë i nxin krahrorit ndonjë plasë;
Nuk fluturojnë pranë tij as korbat
Dh'ai krenar kurrkujt s'pranon t'i flasë.

Por ç'po shikoj! Mes pluhurit dhe erës
Një qenje mu si shpend veshur kaki
Ngul kthetrat mbi një gungë mes humnerës
Dhe tundet mali plak nga klithmë e tij!

. . . . . : :

Dëgjoj plot kërshëri, sot, klithmën-këngë
Që po shpërndan në Drin ky guximtar:
Varur greminës nën një fill litar —
E ndjej në zemër krenari e brengë.

E tek ngulit shikimin nga kjo skenë,
Që të kujton diçka të re... përrallore,
Ushton një zë, si thellë nga ndonjë stenë[1]):
— Po çelim te ky shkëmb
Një minierë diellore! —

1) Një gropë brënda shkëmbit

TI...

Ti, je, si ajo lulja e vogël e kaltër,
Që mbin mes gurëve, pranë ferrave
Dhe s'jeton për t'u dukur.

Piklohesh faqeve me baltë,
Pluhrosesh rrugëve të kantiereve
Dhe shpesh të zbret në ballë
Një kaçurrel i bukur.

Të vrej me dashuri...
Herë më ngjan e largët
Si yjtë përmbi Danjë ndonjë mbrëmje,
Kur bijen në qetësi maqinat

Herë më ngjan e afërt
Si yjtë sipër kokave të murrme të shkëmbenjve,
Kur i shikoj që nga lugina.

TË GJETA PËRSËRI...

Kur thuajse kisha harruar fare,
Pas pesëmbëdhjetë vjetëve,
të gjeta përsëri,
Si një thesar në një qytet gërmadhë:
Po ishe ti...
Shtatëmbëdhjetvjeçare,
Me flokët kokoridhka dhe atë fustan të bardhë.

Më rroke tërë mall, edhe më pyete me nxitim,
Ndërsa të ndrinin në fytyrë lot e buzëqeshje:
— Ku ndodhemi kështu?
— Në Drin...
Në zajet e rinisë së përjetëshme. —

Kalonim pranë e pranë hijes të maleve,
Teksa gjëmonin minat në luginë.
E ti më pyete sërish:
— Nga vemë kaqë larg në këtë buzëmbrëmje?
— Mëngjezeve të bukura që vinë.

Filloi të fryjë lumit erë e fortë
Dhe flokët kokoridhka po t'i shpupuriste.
Ti m'u afrove pranë:
— Kam të ftohtë... —
Unë të mbulova supet me peliçe.

PEJZAZH PAS MESIT TË NATËS

Si brodhi, s'di sa kohë, nëpër botë
E qeshur, e palodhur, e mirfilltë:
Mbi Drinin tonë zbret kjo hënë e plotë
Si një kaminë me prush të trëndafiltë

Duke batisur lehtazi në shpuzë
Zadrimës,
Mbi ca kodra si gëdhenj
Ajo na vren sërish...
Me gaz në buzë
Florin' e fundit ndan nëpër shkëmbënj.

Mandej humbet, në ças, se papandehur
Bie e fle në det.
Zbret një sekondë qetsia.
Sodit këtë pejzazh mu si i dehur...
Më ngjan se shtang dhe lumi nga habia

KUR BIE NATA

Ja tek platit, ngadalë, grykave nata
E freskët,
Kaltëroshe,
E mistershme...
Sikur t'i shpupurish ato flokët e gjata
Mbi supet lakuriqe
Të shpellave të përjetëshme.

I nderën majat rrotull siluetat,
Lundrojnë hije, drita nëpër zall.
Po mos të kish merzin' e ndarjes jeta,
S'do kish takim të dashur:
Prush e mall.

Gërmoj me sondë, thellë, ndër epoka
Dhe kuvendoj me ty
Plot dhëmbshuri:
Po mos të kish armiq kaq t'egër toka,
S'kish mote të Mëdhenj...
As Shqipëri.

LAJMË KËMISHË

Punëtorët lajnë, sot, këmishat.
Në shkumë po notojnë duart e plasura;
U ngjan se përkëdhelin mbi të linjtat
Gishtrinjtë e nuseve të dashura.

Përvesh dhe unë mëngët
E nis fërkoj mbi pllo̧ça.
Më ngjan sikur me shkumën stisim këngën,
Që thur në luftë koha.

Veç s'qenka, jo, kjo këngë
Musi spërkatja me najazmë,
Dikur në oborr të kishës:
Më lehtë e kam të gdhënd një shkëmb me kazmë
Se të zbardhoj, pak, jakën e këmishës.

Por s'kthehemi ne prapa, jo, kurrë!
Do rri të laj gjithë ditën me punëtorët
Mes këtij përroj të kthjellët,
Që gjarpron nëpër gurë
E jakën do ta zbardh dëborë.

SI MOS TË KUVENDOJ ME TY?

Ne kemi dhjetë vjet, që kuvendojmë bashkë
Dhe sonte ndjej se kemi folur fare pakë...
Po del që nga shkëmbinjtë e bukura hënë;
U thuaj, nesër, shoqeve qysh kuvenduam mbrëmë.

Si mos të bisedoj sërish me ty
Për zoqtë, për pllanuçkat e për yjtë?

Je lodhur, ndofta, përsëri në punë
Qerpikët të rëndojnë shumë
Dh'ashtu me gjumë ndër qepallë
Të vjen sikur... po ngjitem nëpër shkallë.

Po vij të kuvendoj sërish me ty
Kangjellave të qerpikëve po hyj!

Ti, ndofta, prap lan plloçat në kuzhinë,
Veç hapat e akrepit të prishin qetësinë...
Mos m'u zemro në lënça disa gjurmë
Tashti, për pak, kur do të lëmë turnin.

Po vij të kuvendoj sërish me ty
Kangjellave e qepallave po shtyj.

Jam zhyer pak si shumë nëpër baltë.
Mos më qorto nën këtë qiell të kaltër
Se kurrë në jetë gjer në këtë orë
S'jam ndodhur, jo, kaq pranë me puntorët!

Ata më buzëqeshin, shpesh, me sy...
Qysh mos ta sjell këtë sihariq
Tek ti!

SA BUKUR...

(në telefon).

Dëgjoj, së largu, zërin tënd të thellë
Dëgjoj, së largu, zërin tënd të butë
E më kujtohet një burim i kthjellët,
Nën hijen e një pishe të zhdërvjellët
Që gjesh e piva, krejt, dikur... në luftë.

Fillojnë e dridhen xhamet këtë natë
Nga grykë e Drinit oshëtin stuhia.
Sa bukur,
Kur mes zërave të shtërgatës
Dëgjon një zë të njohur, kaq të afërt...
E ndjen në gji, ç'fuqi ka dashuria.

DUKE DËGJUAR KËNGËN QË TË PËLQEN

Te ky liqen i këndshëm gjithë drita
Po ndjej një dritë t'ëmbël,
Komparsita.

Më zbrite ti
Mes valëve dhe ondeve
Në pellgun plot argjil, bri sondave.

Më shkunde ti petalet e kujtimeve
Për dashurinë
Te ky shesh-aerodrom...
I ditëve që vinë.

Dhe unë, që vrapova shpejt në pistë,
Pas çapeve të flokverdhës
Komparsitë:

Po të sjell këtë natë,
Në vënd të trëndafilave,
Duart e mia të forta,
Duart e mia gjithë baltë.

LINDJE

Papritur nata dhe më shumë u err.
Ndjej gishtat e veriut që më flladit në faqe
Dhe çapet e mëngjezit, larg, n'eter...
Ja mugëtira, ngjyrë manushaqe!

Fillojnë e shfaqen nëpër qielln' e mugët,
Si vijat e si njollat në një skemë,
Ca forma brigjesh, kodrat, ndonjë pemë
Dhe ndonjë hije që lëviz në rrugë.

Unë luftoj, vendosmërisht, me gjumin...
Në kullat e UKS-eve dhe majave
Hëna me Diellin po ndërrojnë turnin;
Ndërsa epokat ndrrojnë turnin zajeve.

E dashur, folmë, ç'pështpëritin valët?
Eja të dalim zallit në shëtitje.
Shih, nga jorgan i purpurt qitin kokën malet:
Kuqlon
E mrekullueshmja Lindje!

KJO BALTË E KUQE

Godasin sondat tona pa pushim
E dridhen, shpesh, litarët e çelniktë.
Dhe digë e madhe rrënjët thellë i shtrin
Si ankora çeliku
Mbi shkëmbinjtë.

E na spërkatet me argjil fytyra
Kur bëjmë n'atë vend pastrim
Dhe flokët na përthinjen drizë.
Por ç'është, shokë, vallë, kjo surprizë?
Teksa qitim zhavor që nga ky zall pa fund
Shikojmë dhé të kuq!

Nga të ketë ardhur te ky zall kjo baltë,
Q'e nxuarmë, ne, me kovë?
Mos e ka çuar dhuratë
Pas Drinit,
Me një pjesë të zemrës,
E Kuqeja Kosovë
Për këtë bazament të Komunizmit.

EPITAF

Mbi gurin e varrit të Kanunit

Kanuni nxirrte dhëmbët, mbushur helm, si cfurqe,
Që grinin e kafshonin
Ku të mundin.
Njerëzit
Hanin vëllezërit
Si ujqër.

Kanuni hapte krahët
Edhe lisat tok
Lëshonte hije musi korb
Rrjedhës së lumit.
Dhe hijë e tij mund të sterronte
Dhe më të bukurën ditë...
Kanuni i hante dijes sytë
Dhe dritës mushkëritë.

Dhe ku lëshonte shpënd i kobshëm pëndë
Nuk tundesh djep
E nuk dëgjohesh këngë...

S'i trëmbeshin njerëzit topit
Gjëmës, lumit —
Por Kanunit.

Se mbylleshin njerëzit nëpër kulla
Me dekada...
Të gjallë dhe të vdekur të pakallur?
Ngatërrohesh dita edhe nata.
Qefinin endnin trimat nëpër llulla...
Edhe nuk kish të nginjur kurrë
Kjo luftë e pashpallur.

POEMAT

ÇIKAT E MALEVE DHE DRINI

I

Përdridhte, shpesh, mustaqet si pollogë
Lekë Dukagjini,
Nga Lum' i Matit gjer në Bogë
E gjith vadës së Drinit.

Dhe kur përplaste prej zemrimit këmbët,
Despot' i egër i Malësisë,
Gërmadha tymi ngriheshin mbi tokë.
E i mbetej fjala gruas nëpër dhëmbë
Si një kothere e thatë
Shumë e fortë.

Se fjal' e tij ish ligj... dhe ligj i rreptë,
Që duhej ta përtypje dhe kur s'përtypej
kurrë:
Të hidhej vajza prej greminës s'egër
(E ç'mund të bënte tjetër çikë e ngratë?)
Apo të shitej posi dhi në treg
Te kushdo burrë,
Që numëronte si xhambaz paratë?

Por, ja: ashtu siç rriten majave borigat
Të gjelbërta, të drejta, të shëndetshme
E s'tundeshin nga rrebeshet e dëbora, —
Ndër këto gërxhe t'ashpra rriteshin çika:
Shota Galica,
Mrika, Shkurta, Nora...
Krenare si borigat mbi majat e përjetshme.

Dhe kur, papritur, mu si erozionet
Armiqtë rreth sulmonin këtë vënd,
Nuk i lëshonin çikat pozicionet
Dhe kur krasiteshin nga plumbat e nga shpatat
Krënt[1])!

Luftonin gratë, shpesh, me burrat bashkë.
Qëllonin tok me ta të njëjtën shënjë...
Me gishtat delikat' u lidhnin plagët,
Rrëmihnin varre për të rënët.

Dhe m'ato duar të stërvitura,
Në magje, në qilizmë
Apo në tharrje,
(Edhe kur ndodhnin çika të parritura)
Shkonin me heroizmë
Në hakmarrje.

1) Degët e lëngëzuara të ahut që e hanë shumë dhitë.

Po, rrallë e tek ka njohur bota
Krenare si Teuta
Dhe si Shota!

Por, kur mbaronte nëpër maja lufta
E u thureshin qindra kënge trimërive,
Me çifteli, me fyej e lahuta,
(Q'u liheshin trashëgim mu si thesar
breznive)

Ndërsa vazhdonin kënget ehon grykave
gjer vonë,
Trimreshat kyçeshin mes mureve
Pas një brave...
Dhe pasi varnin pushkët në peronë,
Jetonin në shtëpinë e vet sërishmi...
Skllave!

Dhe vrenin nga frëngjitë me pikllim,
Duke u djegur flakë e prush përbrenda
Tek lahej hën' e plotë,
Hën' e lirë... nëpër Drin.

E mijëra dëshira, dashuri
Dhe ëndërra,
Që dergjeshin, tok me to, në një qeli:
Gjith' mall për hapësirat e maleve të
lartër,
I flaknin plot shqetsim
E dhëmbshuri,

Në shtratin tënd, o Drin...
Qivur i kaltër.

Edhe kështu,
Me vite e shekuj rresht,
Si një hamall varrimesh,
O Drini Plak:
Varrosje shpresat, brengat, ëndërrimet
Diku larg...
Në det.
. . . . . ,

NATË VERE

II

Kam dalë sonte dhe shëtit në lumë
Në këtë natë vere kaq të vakët.
Shëtit... në zall' e ngrohtë zbathur
Posi dikur në fëmirinë e largët
Dhe nuk kam gjumë...

Shëtit e vërshëllej një melodi të re.
Djalosh ëndërrimtar,
Pa thinjë, pa halle,
Pa mërzi...
Vështroj si tokën faqes së lumit malet
Me degët e një rrapi qindvjeçar
Dhe kullën e një sonde përkarshi.
Dëgjoj si zgjohen gjethet në dremitje...
Dhe s'më shpëton as dhe një shushuritje.

Por shpejt ndaloj në vënd: ç'të jenë
ato atje:
Sirena, zana apo shtojzavalle?
E kujt i kanë zënë, vallë sonte pritë?

Po pse nuk paskan hedhur supeve ndonjë re·
Të purpurtë
Si shall të trëndafiltë?

Ato nuk janë ora e shtojzavalle,
Po çika vullnetare.
I kanë lënë futat e xhubletat,
I kanë lënë syskat edhe bejkat;
Nuk vënë dushk, për dimër, majë bigës
Dhe nuk ngarkojnë dru nëpër tërkuza:
Po ngrenë çikat mur' e madh të digës,
U këndon zemra dhe u qeshet buza!

Nuk janë më ato të bindura si delet,
Që mund t'i mbajë kyç çfardo lese.
Lëshuar nëpër ballë kaçurrelet,
Stolisur faqet me sumbulla djerse:
Po mbajnë gurë çikat në tezgere...
Mbi Drin vrapojnë yjet,

Natë vere.

Dhe shumë vonë, kur punën e lënë,
Na marrin të gëzuara një valle.
I lan nëpër flori e bukura hënë
Të hijshmet shtojzavalle... vullnetare.

Veç nga kjo këngë e flaktë buzë Drinit,
Na zgjohet tërë inat Lekë Dukagjini:
(Kushedi nga ç'djall magjie dhe nga ç'lëng

Ky burr' i egër qenka bërë shkëmb?)
I thinjur, hijerëndë, Perëndi,
Vështron ai valltaret plot mëri
Dhe murmurit, ashtu, me zë të çjerrë.

— Ku jeni rritur ju, ku keni lerë?
Jeni peri a çika? A ç'dreq xhins?! —
Hedh syt' e zgurdulluar rreth e qark
E duket midis shkrepave një sfinks:
I tmerrshëm, i perëndishëm...
Por qesharak.

E tallen çikat, qeshin...
Dhe vallen asnjë çast s'e lënë.
U merr ky fllad i malit kaçurrelet,
E qeshin çikat, qeshin plot potere;
I lan nëpër flori e bukura hënë.
Mbi Drin vrapojnë yjet...
Natë vere.

KOMUNISTJA

Mami, mos u mërzit. Unë do të bëhem si Shkurte Pal Vata.

Ime bijë, fatose.

Fëmijët janë krahëlehtë si mjergullat
E hedhin, fët, vlastar si pjergullat;
Nxitojnë
Ashtu si bredhin Alpeve ato kopetë e dreve,
U hipin kaliqafë kuajve të reve,
Edhe humbasin pranë lodrave pa fund. .
E kur çukasin pak gishtrinjt' e këmbëve ndokund,
Harrojnë menjëherë dhëmbjen.
Veç kthehen të kapitur, krejt, në mbrëmje
E këputen sipër gjunjëve të thinjosheve,
Që s'ndahen dot nga furka.
E dini kush po fle në prehërin e gjyshes
Aty pas zjarrit, n'atë qoshe?
Shkurta.

Atë e patën shoqe qingjat, kedhat,
Gushkuqët që cicëronin nëpër ferra,
Syt' e kulluar të burimeve,

Ku papandehur binte n'ëndërrime,
Lulet e bjeshkëve që mbinin nën gëmushë,
Çapkënëtë, qimeverdhëtë gjëmbushë...
Dhe çap i saj humbiste si këngë nëpër guva.
E dini kush kalonte?
Shkurta.

Nuk ishte as peri
As shtojzavalle,
S'këndohej këng' ende për të, ndër këta male,
S'vajtonte as një fyell nga lugjet e nga brigjet,
Ish si një xixëllonjë,
Që s'djeg kërkënd e s'digjet.
Veç teksa shkelte hijet e tërkuzëve,
Që nxinin si nepërka nëpër fshat,
S'i shqitej një mëngjez i kuq prej buzëve...
Dhe, vetvetiu, e çonte kokën lart.
Kalonte ky mëngjez tej kullave të gurta.
O, ç'ndeshje e çuditëshme!
Me muret mijvjeçarë ndeshej
Pesëmbëdhjetëvjeçarja... Shkurta.

Kaloj në rrugë. Fryn e shkon stuhia.
Përplasen cërkat flokëve të mia
Ashtu siç plasen valët pas shkëmbënjve.
Nuk ndjej në këtë ndeshje as lodhje as dhëmbje.
Vetëm çapitem mengadalë nëpër baltë,
Pa vënë re as veten time,
Si një që shkel në zalln' e detit natën...
E, kur rrëzohen kodrave ato hijet e mugta
E bien grykat ndër mendime,

Dëgjoj një zë:
— Hej, shok, mos je plagosur vallë?
Na këtë shall të kuq, lidh plagën...
Nuk më njeh? Jam Shkurta.

Ajo leu në një kënd mes blozës e frëngjive.
I thirrën:
— Mirëse vjen! — zilet e bagëtive.
Edhe një bulk i shkathët në një gëzhojë strukur
Filloi të cicërojë, për të, diçka të bukur.
Kur qau në gjin' e bardhë, nëna filloi ta mkojë
Dhe nuk i shkoi ndër mend,
Se mkonte një shqiponjë;
Që do t'i bënte vend,
Në krye të kuvendit
Dhe vetë, kapedani i maleve, Mehmet Shpendi.

Ka ditë që bie shi dhe gryka nxin nga lloha.
Vjen mbrëmja me lagështirë,
Fryn era, tunden sondat.
Buçasin rrugët si përrënj, mbushur nga ujët e
nga llumi.
E, breg më breg, vërshon mes zallit lumi.
Punoj, te buzë e rrjedhës, poshtë, rrëzë gabioneve:
Një qime larg prej dallgëve dhe honeve.
Por ç'është ai zë që sjell kaq qartë nata?
— Hej, punëtor, punoj dhe unë pranë teje! —
E ndjej, kush flet, e ndjej...
Pesëmbëdhjetëvjeçarja komuniste
Shkurte Pal Vata.

U hap ky emr' i saj
Si vesërat në maj.
Mu si gjëmim pranvere u hap ky emr' i saj.
Dh'ai që gjatë viteve qe lodhur
E ndjeu veten, disi, të shlodhur.
— Hej ti, dembel,
Që fle me muaj si ariu në shtrofkë,
Akoma s'u përmënde?
Dhe ti,
Që mban samarn' e kaçamillit si ari mbi kokë,
Nuk u mërzite pak
Me veten tënde? —
Kurse ai që çapej drejt dëgjoi:
— Shih dhe më larg... shih majave të larta! —
E dini kush i tundi fushë e male?
Pesëmbëdhjetëvjeçarja komuniste
Shkurte Pal Vata.

Partia është toka e begatë,
Ku mbjell hibrid'n e vet çdo gjeneratë,
Virtyti mos të fishket n'asnjë stinë,
Mendim i ndritur
Mos mbulohet thinjë.
Nuk njeh kjo tokë e re kurrfarë limiti,
Nuk ka mbarim kjo tokë;
Se mbjell njerzimi bukurinë e shpirtit
Dhe Dielli pshtet mbi të, plot ëndje, kokën.
Ç'u veshën malet, sot, me vello të purpurta
Sikur u hapën qiejtë.
E kush kalon, ashtu, me dritat e së nesërmes
përmbi supa?

E urta,
E vogla,

Sypatrembura...
Shkurta.

Nuk di, kish sy të kaltër apo sy gështenjë.
M'i kish të zeza flokët a të verdhë.
Ma kishte trupin t'imtë
A qipariz të gjatë:
Ma kishte fjalën t'idhtë
A t'ëmbël mjaltë.
Veç si dëbor' e maleve zemrën të bardhë e kishte
Dhe kishte një dëshirë:
Të bëhej komuniste.
Na ktheu sërish rininë e na dha flatra:
Pesëmbëdhjetëvjeçarja komuniste
Shkurte Pal Vata.

I dashur Pal, jam prind, ashtu si ti dhe unë.
Jam gdhirë pranë djepit, shpesh, pa gjumë
Kur kishte vogëlushja pak të nxehtë.
Kam numëruar shtazët, peshqit, shpeztë,
Kandilët endacakë
Në horizont,
Që të kënaqja foshnjën, sadopakë.
O Pal,
M'e lehtë qe për ty të hidheshe në flakë,
Se sa të zije vënd aty në front,
Në pozicion' e s'atë bije.
O prind, në duart e tua t'ashpra dhe të sigurta,
Që nuk po dridhen as në këtë gjëmë,
Sa hije paska arm' e saj, sa hije!
Qëndro!
Në këtë fushë të pamatë, dje, ka rënë

M'e urta
Vajzë e maleve...
Shkurta.
Ajo vështronte yjet, mbrëmjeve, që në prak.
E ç'thosh ai shikim rinor,
Ç'kërkonte, vallë, aq larg?
«Dëshmorët bëhen yje, thotë gjyshja. Ndofta...
Ata të tre te majë e Bigës janë Zoja, Bulja...
Dhe ndofta Shota.
Kurse ai q'i rri mbi kok' Errshellit,
E kush të jetë vallë?
Nuk di, heronjtë janë më të shumtë,
Apo yjet e qiellit»?...
Shkëlqejnë sonte mijra xixëllonja...
Mos po kuqlojnë, prapë, zjarret partizanë?
Mos si për mrekulli
Po bien yjt' e qiellit mbi Malsi,
Që të pëlcasë nga zemrimi nata?
Jo, jo!
Po mbjell thëngjij të kuq prap maleve:
E mitura,
Komunistja Shkurte Pal Vata.

Në një pallat të madh të trëndafiltë
Po ngjiten kësaj mbrëmjeje mijra komunistë.
Ata po vijnë, duket, nga çdo anë:
Mes tyre sheh të rinj e veteranë.
Ja dhe martirët!
Plagët me bandazhe,
M'u kuqëlojnë përsëri
Sikur kanë ardhur prej përpjekjes,
Nga burgjet dhe blindazhet.
Dikush pranohet në Parti...

Pas vdekjes!
Papritur, pyll, më këmbë çohet garda:
Po hyn në sallë
E parritura,
E bukura,
E thinjura...
Pesëmbëdhjetëvjeçarja komuniste Shkurte Pal Vata.

Ajo luftoi trimrisht.
Me pushkë, me mashinkë, me granatë?
Jo, me lopatë.
Dh'atje ku shkoi... s'u gjendën armë dhe flamuj trofe,
Po disa bula gjaku e një mullar me dhe.
E qanë atë njësoj:
Malësori, fusharaku, labi...
E qanë atë njësoj
Tomorri, Myzeqeja dhe Korabi.

Dhe n'atë çast të zi, kur syr' i madh iu err
Me Palin, tok, lotoi si prind dhe Ai
(Q'e thirri pranë, shpesh, në agoni)
Prijësi i Urtë... Xhaxhi Enver.

Tashti, aty ku ra, tek lapidar' i saj
Si një korij' e gjelbër shkon brigata.
N'atë blerim dallon nga larg një shkëmb thinjosh:
Babaj!
Kurse në ballë prin sërish:

E thjeshta,
E hareshmja,
E bukura,
E pavdekshmja...
Pesëmbëdhjetëvjeçarja komuniste
Shkurte Pal Vata.

Vau i Dejës, nëntor 1967

QËNDRESA

«Ai që do të luftojë, s'mund të bëjë pa komandant. Dhe në qoftë se sot nuk rron Stalini, ne do të luftojmë në batalionet e Mao Ce Dunit dhe të Enver Hoxhës».

Nga trakti programatik i komunistëve (bolshevikë) revolucionarë sovjetikë.

Shqipëria është vend i vogël. Flas me bindje:
Mund t'ja pushtosh dhe perëndim
Dhe lindje
Me një të hapur krahët,
Ndaj kufitë
S'përputhen dot këtu me shpejtësitë
E shekullit Njëzet.
Aviatori s'mund ta përbushë kurrsesi dëshirën.
Që ka njeriu në qiell, kur çan hapsirën
E gjerësinë e saj ndjen në kraharor:
Për tri minuta del në det...
Për tri minuta ngjitet në Tomorr.

Shqipëria vend i vogël. Është e qartë:
(Nuk jua them për qarje as për qibër)
Kjo mund të shihet në çdo hartë,
Mund të lexohet në çdo libër,
Që përqas popujt edhe shtetet.
Shqipëria vënd i vogël.
E vogël, ndofta, do të mbetet.

Shqipëria vend i vogël gungë-gungë.
Në shekullin Njëzet, ndokush, e qojti xhunglë
Në jugë të «kontinentit-diell»,
Ku mund të vreje dhe njerëz me bisht.
Ndokush tregonte këtë vend me gisht
Por, kur Atë
Prijsin e Madh dhe t'Urtë,
Q'e kishte ngrysur jetën veç në luftë,
E zboi atdheu i madh pa anë dhe pa fund,
(Nga kjo padrejtësi dhe Himalaja u tund)!
U ndodh ky vënd i vogël,
Të cilin e tregojnë, prap, dhe sot me gisht,
Q'e priti Prometeun
Bujarisht.

Por, kur Atë
Ushtar'n e Madh plot thinjë,
Që për një çerek shekulli mbajti Drejtësinë
Dhe hallet e njerzimit përmbi sup,
E zhveshën, e njollosën plot me turp;
E lyen
Dh'e përlyen ndryshk' e zgjyrë
I hodhën baltë e pshtymë në fytyrë,
Në kontinent diku...
Mes maleve të lartër,

Buroi gjithmonë,
S'shteroi... një gurrë shum' e pastër
Ku Prijsi ballët lau plot dhëmbshuri.
Kjo gurrë e kthjellët m'ish:
E vogla Shqipëri.

Evropa dha gjeninj' edhe kolosë,
Të cilët, nuk mbulohen dot me blozën,
Që hodhi Majdaniku në blerimn' e stinës
As me çadëren gri të Hiroshimës.
Evropa nxori Shekspir' e Bet'hovenë,
Përkundi, po, në djep, Spartakun' e Galilenë,
Viganin avull futi nën teligë
Dhe mijëra pishtarë çoi n'orbitë!
U ndodh edhe këtu, mes maleve të lartë
Një Kruj' e Re sërish...
Në barrikatë.

Pat vende të mëdha e të stërlashta,
Që zënë shumë tok'e det në harta.
Pat kombe të lavdishm' e fanatikë,
T'etuar për liri dhe për epikë,
Q'i patnë ngritur Drejtësisë tempuj,
Të cilët s'mund të shemben as ndër shekuj.
Por, kur Atë[1]) — q'u kalli drithma tmerri
Gjithë tiranve që kish pjellë dheri,
Duke groposur kulla, frone, palla,
Sa tërë divat bashkë në përralla —
E mbytën tradhëtisht nëpër një kurth të ndytë,
Drejt Tij, në kontinent,
Ngriti zënë e saj kreshnik!..

1) Është fjala për Stalinin.

Kur mjergulla m'i nderte krahët qiellit pis,
Ashtu siç tiret brigjeve
Mbi Tamiz;
Kur retë rridhnin shi edhe radium,
E kish pak oksigjen
E shumë opium,
Kur s'mbushej dot me frymë krahërori
Dhe belbëzonte si memec
Tetori
Kur hapej si kolerë diviz' e zezë,
Dhe s'mund t'i rroknin armët, prap
Heronjt' e Murit «Per Lashezë»;

Kur, korreshin militantët që pas gardhit,
E s'mund të ngriheshin dot
Heronjt' e Stalingradit;
Kur shfrynte me nxitim në kontinent
Mu si batak i qelbur tradhëtia,
M'atë rrëmbim të marrë, që të çmend
Dhe qitnin kryet lart shkërbajat më të humbura,
Dhe thyheshin ëndërrat tona më të bukura,
Posi kristal në qindra-mijë copa,
Dëgjonte xhaz
E pinte uiski Evropa...
Kur velin ugurzi valvitte tragjedia,
Zbuloi krahror' e saj granit...
Partia e Punës,
Shqipëria.

KUR E SHIKOJMË BOTËN ME SYT' E ZEMRËS

F. Çelës

Ti ke pirë ujë në Tomorr
Dhe unë në Lenije.
E kemi çarë tokën me një plor
Dhe jemi çlodhur, ndofta, nën një hije.
I kemi ngrënë groshët, mbrëmjes, me nagjazmë
E bukën nga çerepi
Kemi rrëmihur një copë kopsht me kazmë
Nga brinjët e fildishta të një shkrepi.

Dhe plumbat që të korrën, ty, xhaxhanë
Më kanë vërshëllyer dhe mua fare pranë;
E më shpëtoi, veç rastësisht, një pemë
(E varfra mori vetë shumë plagë),
Të shkruaj, ndofta, sot, këtë poemë.

* * *

I dashur shok,
Nuk do të flas me ty,

Siç mund të flitet, shpesh, me një të verbër.
Po, sonte ndrijnë yjtë...
Mëngjezi është i kuq...
Koria është e gjelbër...

Nuk do të them:
Përtej qëndron një majë e lartë.
Apo: çapitu me kujdes...
Ka baltë!
S'po të tregoj,
Si çel qerpikët dalngadalë
Ky mëngjes
E hapet në shkëmbinjt' e Vaut të Dejës,
Posi një këngë e bukur
Pa fjalë.
S'po të tregoj...
Ti e shikon gjithshka me sytë e zemrës.

Ti e ndjen mirë:
Se gurra është e kthjellët,
Se gonxh' e trëndafilit nis e çelet
Kur zë një vesë shi;
Qysh lozin pikat nëpër gjethe
Një të mahnitshme melodi,
Që bën të ndjejsh në krahëror rrëqethje.

Ti e vren bukur
Qysh ndrijnë nëpër mjergullat korithat,
Kur gjethet verdhen e këputen
Në një paradë të mërzitshme,
Dhe si ndriçon një natë vjeshte,

Në qiellin e kantiereve
Afërdita:
E madhe, e shkëlqyer
E mahnitshme!

Ti vren gjithshka. Zemra s'të gënjen.
Ruit burimi mes lajthive
E ngjan sikur po vërshëllen
Ndonjë sekret të brishtë djaloshar.
Dhe diçka flet ky flladi në korije
Kur shtrin gishtrinjtë e butë nëpër bar.

Nuk po të them
Qysh endin vajzat basmën ndër tezgjahët,
Duke shtrënguar shaminë nën gushë,
Si shtrinë fluturat nëpër lule krahët
E si vrapon një mëz balash
Në fushë.

Si çan tej Myzeqesë hekurudha,
Si malet tona kanë shumë vraga
Dhe nënat tona kanë shumë rrudha.

Ti vren çdo gjë...
Ngarkohen, shpesh, në dimër pishat
Si mullarë me lecka;
Edhe qindisin në dëborë zoqt' e bishat
Miliona lule rabecka.

Nuk po të them
Qysh nxihen duart e pëlcasin,
Në vlagn' e punës,
Netëve të ftohta
E qysh thëngjinjt' e zjarrit, në cingërimë, flasin.
Një t'ëmbël gjuhë...
Që s'e ka njohur bota.

Pastaj...
S'po të tregoj
Se ç'poezi ka Dielli në mëngjez,
Kur bije
Bregut Drinit përmatanë
Dhe ti e vren nga zalli, nën hije,
(Tek vazhdon punën)
Duke përpjekur këmbët
Mes akujve kallkanë!

* * *

Kaloj në rrugë, ndër mendime,
E flas, si mendimtar, me veten time:
Po. Siç i duhet pyllit ky cicrim i flladit
Dhe grykave muzik' e valës,
Na duhet neve shpesh
Ai kumbim i hapave të njerëzve
Dh'ajo muzik' e fjalës.

Veç kur dëgjon... njeriu kërkon të shohë.
Të shohë nënën,
Tek arnon çorapet,
Fëmijën, që me hijet lot e kapet

Të shohë...
Një sylynjar që vetëtin në krua,
Vajzën,
Tek hedh mbi supe leshrat
E thotë buzëgaz: të dua.

Të shohë
Lulkuqet e çative në një qytet të ri
Tërë jetë,
Që lind për mrekulli
Përmbi një grykë t'egër
A nën një mal të shkretë.

Apo... të shohë
Dritat e hijet e fuqishme
T'atij gëzimi kolektiv,
Që nget me vrap në deje
Dhe na mbush zemrat, prap, plot eksplozivë
Disa minuta pas beteje.

Të shohë...
Të ngre, të përtërit
Të derdh rini e lumtëri në shpirt:
Pamja
E të madhrishmit mozaik,
Që na dhuron përdit' kjo kohë!

I dashur shok,
Kam futur duart 'xhepave, prej së ftohtës,
E kuvendoj me ty:

Ç'kuptim do kish, sikur, kufijt' e botës
Të merrnin fund,
Te mur' i zi i natës?

Ç'kuptim do kish
Sikur, pas gdhëndjes së shatës,
Të mos na shkelnin sytë misr' i mbarë
Dhe ca qershi sheltore, poshtë. n'arë?

Ç'do bëheshe sikur
T'i ngjiste rez' e bardhë një kobi,
Të qe planeti një qeli pa ajër,
Të vishte dheu e deti pendë korbi
Dhe qielli i kaltër
Të dukesh posi zgavër?

Ç'do bëheshe sikur:
Mos vrenin buzët që ngulmojnë
— Vdes për ty! —
Dhe dy lot të smeraldtë lumtërie
Ndër dy sy.
Sikur mos njihnim
Format e gëzimit e të dhëmbjes,
Sikur mos shihnim
Diellin nëpër Drin
Tek lahet në postafn' e kuq të mbrëmjes?

Nuk janë syt' e tu dy shpella, krejt të shkreta,
Të mbytura përjetësisht
Nën hije,

Ku nuk ka zbritur asnjëherë jeta
Veç ndonjë pikë shiu
Që, si lot dhëmbjeje, bije.

Nuk janë syt' e tu mu si dy gropa,
Ku mund të fshihen krodhet e mërzisë
Nga shokët e nga bota
Dhe pikëllim' i njerëzve të shtëpisë.

Nuk janë syt' e tu pasqyra tërë plasa,
Që të na mkojnë pelten e mëshirës.
Ti
Ngjitesh si titan nëpër tarraca,
Drejt majave të malit,
Edhe godet me kazmë
Mbretrinë shekullore t'errësirës
Mu në lule të ballit.

Kush thotë je i verbër?
Ti sheh në thellësit' e detit dhe të zemrës,
Tej murit që shpërndajnë shiu e lloha,
Mes mjergullave ngjyrë-vjollcë t'ëndrës,
Atë që fsheh në krahror dheu e koha.

Ti sheh,
Tej mugëtirës së një mbrëmjeje të lagët,
Vështrimi yt kalon
Tej maleve të largët,
E depërton
Ograjave e korijeve

Tej zhurmave të zbrazëta
Dhe tej hijeve!

E kush nuk do të shohë me të tillë sy?
Vështrimi yt fajkua guximtar,
Duke kaluar kreshtave të viteve,
Na sjell kaq pranë.
Atë pejzazh kaq t'afërt,
Atë pejzazh të bukur...
Pejzazhn' e mrekulluar shqiptar.

* * *

E kush nuk do të shohë me të tillë sy?
Kaq largë...
Dhe kaq mirë.
E kush nuk do të jetë shok me ty,
Në këtë luftë të vështirë?

Ti ngrihesh sipër thashethemeve
Dhe vogëlsirave
(Me mizat e mushkonjat merren shpeztë)
E krahët e tu të gjerë shtrin hapsirave
Në kohën pa një re
Apo në shqotë.

Porse ashtu siç vren sqifteri, që nga retë
Mbi një luadh e mbi një skërkë,

Një mi, një breshk' e një nepërkë
Dhe zbret mbi të vetimë
Tatëpjetë,
Sulmon ti plot guxim çdo mbeturinë.

Edhe dallon,
Për bukuri ti
Midis kallinjve t'artë
Një turmbë urth ose një gjëmb të thatë.

Dh'i gjen kudo krekoçët mburravecë,
Që bëjnë çmos të shiten e të duken;
Dembelët, kur tamam si buburecët
Kërkojnë vryma e rrëza,
Që të struken;
E janë gati të hyjnë në kanal.
Nëpër çdo plasë,
Mjafton që mos t'u fshiken duart pak
Dhe dit' e punës mos t'i vrasë!

Sulmon ti burrërisht, ato fuqi të verbëta.
Që brejnë mu si krimbat
Palcën e pemëve të gjelbërta;
Që ndodhen pranë nesh, porse nuk shihen...
E shpesh në veten tonë
Mu si demonë
Fshihen.
Ato vërtiten pranë, rreth e qark,
Nga afër na vërsulen
Dhe nga larg...

Përpiqen t'na ngurosin, mu si xhindet,
Apo si magjistricat, afrojnë, zakonisht,
Diçka të butë,
Nga mbeturinat e tryezave të minjve.
Dhe duhet burrëri
T'u shpallësh luftë
Dhe t'i përsheshësh, me një grusht, turinjve!

Dhe duhet burrëri
Të vresh përdit' vetveten në pasqyrë,
(M'atë kujdes që vren fshatari vreshtat e grunoret)
E të shkrumbosh me bateri tumorret,
Që ke në mushkëri
Në zemër... dhe fytyrë.

* * *

Po, shok. Është e vërtetë:
Në istikam do mbetemi përpjetë
Dhe do ta shoshim vetveten në sitë,
Siç na mëson Mësuesi ynë i Madh...
Përditë.

Veç duhet fort kujdes
Se gremërat e ndyra e të verbëta,
Që dalin, zakonisht, në lagështirë,
U thithin gjakun kajëzve të gjelbër
Dhe mund t'na e kthejnë fushën
Në shkretirë.
Dhe s'është gjë e lehtë
Të gjejsh, të shkulësh dhe të shkrumbosh,
Çdo fije grem,

Kudo të jetë strukur
E të shpëtosh...
Atë kallin e blertë.
Dhe të shpëtosh...
Atë kallin e bukur.

Dhe s'është pun' e lehtë
Të grryejsh prej krahrorit kalbësirën,
Si një kirurg me tehn' e thikës,
E, kur flakrojn' e ndezin hapësirën,
Shigjetat llamburitëse të kritikës
Dhe të zhuritet buza si në luftë:
Mos të të mbytë cmira e mëria
E t'i kërkosh vetmisë... një kënd të butë
Si një i lodhur fort nga dashuria.

Dhe duhet dashuri
Që degën rakitike e verdhacuke
Në trungun e ndërgjegjes,
Ku çelin gjëmbat e ambicies e të sedrës,
Duke përçmuar dhëmbj' e krenari,
Ta presësh, gjer në fund, me gërshërën e kuqe.

Dhe të ndjejsh pranë vetes
Atë shikimn' e syve të shokëve
Dhe kur nuk të vështrojnë;
Dhe t'u besosh zemrave të shokëve
Dhe kur nuk të besojnë;
Dhe të vështrosh mes tymit e mes mjergullës,
Ashtu siç shikon ti, vëlla,
Me syt' e zemrës:
Shkëlqimn' e ditëve të mëdha.

Dhe duhet burrëri...
Që n'emërin e shenjtë t'idealit
Mos tundesh, kurrsesi, prej istikamit
Në çdo furtunë dhe stuhi...
E mos t'u fshehësh, nesër, popujve fytyrën
Si një borgjez gërmuq
Dhe gjaku i kuq mos humbë kurrë ngjyrën,
Porse të mbetet përgjithmonë...
I kuq!

I dashur shok,
Ti thua se u ndodhe n'udhëkryq,
Rrethuar mes gërmadhave të padukshme:
Të kyçeshe në qelin' e vetes.
Qyq...
Nënë çatin' e doçkave prej pambuku
Të dhimbjes së të tjerëve,
(Si nj'i përjetshëm qytetar në botën e të mjerëve).

Apo të hidheshe i tëri në përpjekje
Në luftën mbinjerzore
Për jetë... a për vdekje?

Dhe zgjodhe... rrugën heroike.
Nga vitet e nga ditët tona
U shtove një kreshnik
Kreshnikëve.

Po lufta jote ish e rëndë:
Je djegur në qilizmë, shpesh, nga etja.
Dhe nuk ke zbritur të flladitesh tek burimi.

Ke ndjerë qysh zgërdhihet nata,
Aty pas teje:
— Shih, po ecën... trimi! —

Je plasur pas shkëmbënjve,
Por s'e ke bërë veten fare,
Veç ke kafshuar buzët tërë dhëmbje.

Je shembur tek një trap,
Buzë një are
E prap je ngritur.
Ke shkarë në një ledh
E prap je ngjitur.

Ke ardhur mbrëmjes në shtëpi,
Flot shenja plagësh e gërvishtje,
Por në mëngjez je kthyer përsëri,
Në korrje apo në prashitje.

Dhe, kur dikush mendoi për ty, një «vend të mirë»
Pas «mundësive»,
Ti, komunist pa sy,
Duke u dhënë shkelmin «lehtësive»,
Kërkove pozicion te fronti m'i vështirë.

E prap gërmon me kazmë në rrëpira,
Mes pllajash lakuriqe dhe të pjerrta,
Ku plisat kacavjerren ndër gremina.
Diku mbjell vreshta...

Dhe diku shtron shina...
Të ngjeshura, të hekurta, të drejta.

Diku çel rrugë,
Diku, mes gërxheve, shtron telat elektrikë,
Të bëhet jeta edhe m'e bukur,
Të mbushen, natën, odat plot me dritë.

Ti nuk lëron e s'mbjell dot me parmendë,
E kjo të sjell shqetsim
Me siguri.
Dhe ndofta je dërsitur, duke shkruar me pendë.
Atë të dashur Emër,
Emrin Parti.

Dhe vuan, shpesh, mes mureve të dilemave...
Por ecën drejt,
Përpara,
Larg...
Me stoicizmë.
Ndaj heroizmin tënd e vëmë si flamur
Në majat e poemave
Tek hidhemi në sulm...
Për Komunizmë.

Kërkoi ai, mjekroshi Arkimed,
Levën e tij magjike,
Që të zhvendoste tokën mes hapsirës.
Por nuk e gjeti dot.
I shembe ti, vëlla, me kazmë
Muret e trashë qiklopikë
Në mbretërinë mizore t'errësirës!

* * *

Ti ke të drejtë, të kuptoj, vëlla,
Ne lindëm për beteja të vështira
Dhe për gëzime
Shumë të mëdha...

... Mesnatë.
Acari fryn e vërshëllen si grerëz.
Nga Alpet zbret një dimr' i egër.
Shtrëngatë.

Pëllëmbët shtrij, me shokët, që të ngrohem
Mbi zjarrn' e madh që flakëron.
Kullat e hekurta të sondave hepohen,
E duken se do shemben;
Një nga një...
Ndërsa lart mbi Cukal gjëmon.
Vështroj si trëmben
Fluturat e bardha
E kuvendoj me ty...
Pa zë.
Ndërsa shkëmbënjtë heshtin si gërmadha.

Nën çapet tona krisin xhame kristalinë.
Dikush po qan... shih, lotë!
Jo, mos beso, vëlla:
Po shkrijnë

Disa kokrriza akulli mbi qepalla.
Ne po qëndrojmë ashtu si thua ti... të fortë.

Motorët asnjë çast nuk po pushojnë!
Nuk shkelet fjala.

Qëndroj pas kullës që lëkundet,
Edhe vrej shokët:
Ja, pozicionin sonte asnjëri s'e lë!

E kuvendoj me ty sërish... pa zë:
Ti ke të drejtë, të kuptoj, vëlla,
Ndër këto ditë të vështira
Kaqë të mëdha:
Nuk vlejnë as një dysh burrecët,
Djemkat spicë...
Që mund t'i çarmatos' e para ngricë.
Që mund t'i tret' dh'ajo e para vapë,
Që nisen treqind herë në rrugë
Dhe treqind herë
Kthehen prapë!

Nuk i honeps ti, ke të drejtë,
Ata
Që për çdo gjë ankohen,
E tkurren,
Jargaviten,
Pikëllohen:
Pse u këputet prej xhaketës ndonjë pullë...
Dhe veç trishtimin gri pinë në llullë.

Ti ke të drejtë, të kuptoj, vëlla,
Ndër këto ditë të flakta,
Kaq të mëdha:

Duhet volfran...
Metal i temperaturave të larta.

Nuk vlen një dysh ai
Që lagavitet si kallaj.
Dh'ai që peshon sa një pupël
E mund ta flakë rryma në çdo skaj.

Na duhen njerëz si shkëmbinj të rëndë,
Ushtarë të vërtetë,
Që mos t'i shkulë nga pozicioni
As uragani i çmendur
As valë e dymbëdhjetë!

Na duhen njerëz që të qëndrojnë
Në ngricë dhe në flakë
E mos të shkrihen kurrë
As në tremijë gradë!

Ti ke të drejtë, të kuptoj, vëlla.
Ne kemi lindur për beteja të vështira
Dhe për gëzime
Shumë të mëdha.

Vau i Dejës, dhjetor, 1967

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
VJERSHAT	3
I vjetër je, ti, Drin, aq sa kjo botë	5
Punëtorët	7
Si lindi poezia	9
Armiku	11
Minatorët	14
Xixëllonjat	16
Mbytja e egoizmit	18
Natë Betonimi	21
Në breg të Drinit	24
Frroku	27
Elegji për kryesondistin	30
Copëza pejzazhesh nga turni i natës	33
Po ktheheshim një mëngjez me shi nga turni	35
Gëzimi	37
Debat në kantier	39
Panoramë	42
Bisedë me mjeshtrin	44
Mekanikët	46
Kulla në fund të liqenit	49
I shkreti... psallt	51
Transportimi i shoferit të plagosur	53
Përplasen antitezat	55
Në dhomën e dezhurnit	57
Pritje	59
Poezia ime më e bukur	61
Përcjellja	63
Ne jemi alpinistë	66
Vështroj të bukurën	67
Liniat elektrike	68

Faqe

Po zbret kjo mugëtira laramane 69
Dhe shtrijmë degët shekujve që vinë 70
Piktores 72
Po të mos mbahej ndezur kjo betejë 73
Grimcë e rërës mund të jetë botë 75
Mesnatë 76
Më duhet një mendim i madh... i hijshëm 77
Natë dimri, rrugëve të kantierit 79
Ty, ndofta, do të të duket... 80
Ja mbushëm malit plot trotil krahrorë 81
Një pejzazhisti 83
Elegji për shoferin 84
Ndërrim turnesh 86
Ditë vjeshte 88
Vrej nga dritarja 89
Ti 91
Të gjeta përsëri 92
Pejzazh pas mezit të natës 94
Kur bie nata 95
Lajmë këmishë 96
Si mos të kuvëndoj me ty? 97
Sa bukur 99
Duke dëgjuar këngën që të pëlqen 100
Lindje 101
Kjo baltë e kuqe 102
Epitaf 103

POEMAT 105

Çikat e maleve dhe Drini 107
Komunistja 114
Qëndresa 122
Kur e shikojmë botën me syt'e zemrës 126

48545

BIBLIOTEKA E SHTETIT